



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor
“Informatikë Ekonomike”
i
Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti
“Metropolitan Tirana”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


1. Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli

2. Prof. Dr. Fatmir Memaj

Nëntor/ 2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Informatikë Ekonomike”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Metropolitan Tirana”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Informatikë Ekonomike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Informatikë Ekonomike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 357, datë 12.05.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMASH Nr. 360, datë 02.09.2013
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UQSHA Nr. 363, datë 23.12.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VKA Nr. 104/1, datë 18.12.2015 UMAS Nr. 10, datë 07.01.2016
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite/ 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit (viti akademik 20-21):	15 PAE/ 7 PAK
18	Numri i studentëve (3 vitet e fundit):	53 studentë
19	Komente / të tjera:	-



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës;

Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është një program studimi me kohë të plotë, me 180 kredite, që ofrohet në 6 semestra apo 3 vite akademike, në përfundim të të cilave merret diploma me profilin përkatës. Programi është hapur me VKM Nr. 357, datë 12.05.2010 dhe riorganizuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 360, datë 02.09.2013. Universiteti “Metropolitan Tirana” (UMT) është krijuar në zbatim të ligjit “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë bazuar në VKM Nr. 357, datë 12.05.2010 “Për licencimin si Institucion i Arsimit të lartë”. Me Urdhër nr.519, datë 18.10.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, ky institucion është pajisur me leje për fillimin e veprimtarisë mësimore e kërkimore dhe akademike të programeve të studimit në përputhje me licencën e dhënë, duke filluar veprimtarinë e saj akademike qysh në fillim të vitit mësimor 2011-2012.

Programi i studimit Bsc në “Informatikë Ekonomike”, ofrohet nga Departamenti i Informatikës Ekonomike, njësi e vendosur në Fakultetin e Ekonomisë.

Universiteti “Metropolitan Tirana” ka përcaktuar qartë drejtimet prioritare akademike në dokumentat e veta strategjike dhe synon ndërtimin e të gjitha kurrikulave në përputhje me kërkesat e “Kartës së Bolonjës” dhe përshtatjen e tyre me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut të punës. Realizimi i këtyre prioritetëve synohet nëpërmjet përmbushjes së Misionit të UMT të përcaktuar në Statutin e Universitetit Metropolitan Tirana Tirana, siç cilesohet Aneksi Nr. 01, Neni 4 i Statutit të UMT.

Përgjatë procesit të vlerësimit të jashtëm, GVJ konstatoi se ky program studimi është ofruar në përputhje me këto prioritete. Ofrimi i programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij janë në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të Universiteti “Metropolitan Tirana”. Ky program studimi ofron njohuri teorike dhe aftësi praktike në ekonomiks, financë, kontabilitet, programim, rrjeta kompjuterike, etj. Studenti, i cili zotëron një diplomë të tillë mund të punësohet në institucione të ndryshme si specialist në sektorin e Teknologjisë së Informacionit si në sektorin publik edhe atë privat.

Ky raport u përgatitur nga ana e Grupi të Vlersimit të Jashtëm dhe ka për qëllim vlerësimin në kuadër të ri-akreditimit për programin e studimit Bachelor në ‘Informatikë Ekonomike’.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË


Akreditimi i programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Metropolitan Tirana”, është bërë për herë të parë me Urdhër të MAS Nr. 10, datë 07.01.2016, në bazë të rekomandimeve të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë në Vendimin Nr. 104, datë 03.11.2015. Këshilli i Akreditimit, në vendimin e tij i ka lënë institucionit dy rekomandime:

Rekomandimet

- a) Institucionit i rekomandohet të pasurojë bibliotekën me tituj të literaturës bazë dhe ndihmëse në gjuhën shqipe dhe përmirësimin e nivelit të gjuhës angleze për studentët.

Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. GVJ vlerëson se rekomandimi në lidhje me pasurimin e bibliotekës me tituj të literaturës bazë dhe ndihmëse në gjuhën shqipe është përmbushur. Në bazë të evidencave, të RVB si dhe gjatë vizitës në institucion GVJ konkludon që institucioni ka bërë përpjekje të konsiderueshme për shtimin e fondit të bibliotekës, duke shtuar numrin e librave të literaturës bazë, si dhe të revistave, buletineve, shkencorë, periodikëve, etj. Megjithatë GVJ sugjeron që përsëri ka vend për përmirësimin dhe shtimin e titujve të librave në literaturën fizike apo online, sidomos në gjuhën shqipe, për të mbështetur nevojat e programit Bachelor në Informatikë Ekonomike.
2. GVJ vlerëson se rekomandimi në lidhje me përmirësimin e gjuhës angleze është përmbushur gjithashtu. Në bazë të syllabusit të lëndës së Anglishtes, teksti bazë që përdoret në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike është Business English, botim i vitit 2014. Kjo literaturë i jep mundësi studentëve të marrin njohuri të një niveli të lartë, me terminologji të avancuar të fushës së tyre të studimit. Gjithashtu në takimin me pedagogët, GVJ u informua nga pedagogu i anglishtes, për rritjen reale të nivelit të gjuhës angleze tek studentët e këtij programi, gjë ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e mobiliteteve të studentëve në universitete ndërkombëtare.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;

Vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi është përgatitur nga një grup ekspertësh të kontratuar nga ASCAL. Për hartimin e raportit, veç raportit të vlerësimit të brendshëm, dokumentave mbështetës të sjella nga IAL në Dosjen e Vetëvlerësimit, grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) u bazua edhe në vizitën një ditore që grupi kreu në institucion, si dhe mori në shqyrtim edhe dokumenta të tjera dhe informacion të nxjerrë nga takimet dhe intervistat që u kryen gjatë vizitës në institucion, si për shembull me drejtues të departamentit, personelin akademik dhe studentët, përfaqësues të Zyrës së Standardeve dhe Cilësisë, etj.

Në bazë të vlerësimit kanë qënë kriteret e vendosura në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse.


Metodologjia e ndjekur për shkrimin e këtij raporti është analizimi i dokumentave dhe rishikimi i kriterëve e kërkesave ligjore në lidhje me akreditimin e programeve të studimit të nivelit “Bachelor” në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Vizitat në institucion u kryen në dataën 10 Shtator 2021. Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën e përmbajtjes së kurrikulës dhe lëndëve, shpërndarjes së krediteve dhe orëve, literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik për lëndët që ligjërojnë, sigurimit të cilësisë, etj.

Institucioni dorëzoi dokumentat dhe evidencat e nevojshme për akreditimin në format elektronik tek ASCAL; gjithashtu, gjatë vizitës së GVJ në institucion u paraqitën evidenca të ndryshme për të mbështetur aplikimin e tyre për akreditimin e programit të studimit të nivelit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”. Programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike është i atashuar pranë Fakultetit të Ekonomisë.

Koordinator teknik i ASCAL gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm është Msc. Aviola Bardhi

Më datë 15.11.2021, përmes sistemit AMS, Universiteti “Metropolitan Tirana” është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm për këtë program studimi dhe me shkresë zyrtare Nr. Prot, 26/47, datë 15.11.2021. Më datë 22.11.2021 UMT përcjell në sistemin AMS shkresën me Nr. Prot, 306/1 datë 19.11.2021 me të cilën shpreh dakordësin me përmbajtjen e draftit.

Gjithashtu bashkëngjitur kësaj shkrese UMT ka përcjellë edhe shkresën me Nr. Prot, 306/2 datë 19.11.2021 me anë të të cilës bën disa saktësime të të dhënave të paraqitura në këtë raport. Këto saktësime u morën në konsideratë nga grupi i ekspertëve dhe u reflektuan në Raportin përfundimtar.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Informatikë Ekonomike”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti Metropolitan Tirana ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Kjo gjë është e shprehur qartësisht në Planin Strategjik Vendim Senati Nr: 224/1 08.04.2019 të Universiteti Metropolitan Tirana sipas të cilit ky institucion synon të jetë <i>promovues i vlerave kombëtare nëpërmjet ofrimit të edukimit/arsimit me qëllim nxitjen e rritjes së etikës qytetare, të profesionalizmit, në ndërtimin e modelit të respektimit të kodeve të sjelljes, me synimin për formimin e një qytetarie model për konsolidimin e vlerave dhe interesave kombëtare në fushën e arsimit.</i></p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.03 Planit strategjik i zhvillimit të UMT.pdf</p>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Universiteti Metropolitan Tirana i ka hartuar programet e studimit në përputhje me ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. GVJ e konstaton këtë në dokumentat strategjike të institucionit sipas të cilave Universiteti Metropolitan Tirana ka <i>vizion kthimin e tij në:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Nje qender akademike qe ofron edukim universitar dhe profesional me cilesi te larte bazuar ne ruajtjen, perhapjen dhe krijimin e dijeve dhe qe promovon te mesuarit gjate gjithë jetes;</i> • <i>Nje qender e preferuar nga studentet dhe stafi akademik me kualifikim te larte, qe pergatit studentet me njohurite e nevojshme intelektuale dhe profesionale ne perputhje me kerkesat e tregut te punes;</i> • <i>Nje qender me lidhje te forta si me komunitetin lokal ashtu dhe ate nderkombetar (universitete apo biznese) dhe qe i perdor keto ne dobi te veprimtarive akademike e kerkimore te studenteve dhe stafit akademik;</i> • <i>Nje qender qe kontribuon ne zhvillimin e vendit.”</i> <p>Evidenca: Aneksi Nr.03 Planit Strategjik Nr:224/1 08/04/2019, Vizioni).</p>
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e	<p>Sipas Statutit të Universiteti Metropolitan Tirana, Neni 4, qëllimi dhe misioni i Universiteti Metropolitan Tirana janë:</p>

<p>institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>1 - Ofrimi i arsimimit të lartë dhe veprimtarisë krijuese në fushat e shkencave të aplikuara dhe inxhinierisë, ekonomisë, etj në përputhje me kërkesat dhe nevojat e universitetit.</p> <p>2 - Zhvillimi dhe mbrojtja e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike e kërkimit shkencor që kryhet brenda e jashtë vendit.</p> <p>3 - Formimi i studiuësve të rinj në fushat e shkencave të aplikuara dhe inxhinierisë, ekonomisë etj., nëpërmjet programeve universitare mësimore shkencore të një niveli të përparuar e bashkëkohor teorik, metodik e praktik.</p> <p>4 - Thellimi i kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushat e shkencave të aplikuara dhe inxhinierisë, ekonomisë, etj. Duke ofruar mundësi të mira për të perfutur nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.</p> <p>5 - Kontributi në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit.</p> <p>Mbështetur tek dokumentacioni i shqyrtuar GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit duke ofruar kurrikula dhe mësimdhënie cilësore.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.03 Plani Strategjik Aneksi Nr.53 Dosja e programit - BSC-IE-Te dhena te pergjithshme.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Sipas dokumentave të vëna në dispozicion GVJ konstaton se nëpërmjet këtij programi Universiteti Metropolitan Tirana ka synuar të ofrojë studime në përputhje me nevojat aktuale të tregut lokal dhe kombëtar. Studimet që ka bërë Universiteti Metropolitan Tirana mbi kërkesat e tregut në këtë drejtim, kanë ndihmuar në përputhshmërinë e këtij programi me nevojat e tregut të punës.</p> <p>Ofrimi i këtij programi studimi ka ardhur si kërkesë e tregut të punës për specialistë të Informatikes Ekonomike. Studimet në këtë program synojnë të sigurojnë njohuri në fushën Informatike dhe Ekonomike, pasi përmbajtja e programit i pajis studentet me njohuri teorike dhe praktike, si dhe përgatitje për kërkim shkencor të pavarur në këto fusha.</p> <p>Të diplomuarit në këtë program studimi fitojnë njohuri teorike dhe aftësi praktike në ekonomiks, financë, kontabilitet, programim, rrjeta kompjuterike, etj. Studenti, i cili zotëron një diplomë të tillë mund të punësohet në institucione të ndryshme si specialist në sektorin e Teknologjisë së Informacionit si në sektorin publik edhe atë privat.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.03 Plani Strategjik Aneksi Nr.53 Dosja e programit - BSC-IE-Te dhena te pergjithshme.pdf Aneksi Nr.56 Plan programet syllabuset e programit Beh Informatike Ekonomike.pdf</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 7

	Aneksi Nr.74 Studim tregu per programin e Studim Bach-Informatikë Ekonomike.pdf			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike është hartuar në përshtatje me strategjinë e zhvillimit të vetë institucionit e mbështetur kjo tek dokumentat strategjike të tij. Sipas Planit Strategjik Nr.224/1 datë 08.04.2019 institucioni synon të jetë një qendër ekspertize e specializuar në fushën e teknologjisë, në vend dhe me ndikim në rajon e më gjerë.</p> <p>Sistemi i njohurive që ofrohet nga programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre edhe ndjekjen e një karriere kërkimore apo akademike nëpërmjet vazhdimit të studimeve të ciklit të dytë, duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.03 Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf</p>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë artë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>GVJ konstatoi se Universiteti Metropolitan Tirana ka përcaktuar qartë drejtimit prioritar akademike në dokumentat e veta strategjike të tilla si Plani Strategjik Nr.224/1 date 08.04.2019, sipas të cilave institucioni synon ndërtimin e të gjitha kurrikulave të tij në përputhje me kërkesat e “Kartës së Bolonjës”, dhe përshtatjen e tyre me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut të punës. Realizimi i këtyre prioritetëve synohet nëpërmjet përmbushjes së Misionit të përcaktuara në Statutin e Universitetit Metropolitan Tirana Neni 4. Gjatë vizitës në institucion dhe në bazë të dokumentave të tjera të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, GVJ konstatoi se ky program studimi është ofruar në përputhje me këto prioritete.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.01 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.03 Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf</p>
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	<p>Sipas Planit Strategjik Nr.224/1 datë 08.04.2019, Universiteti Metropolitan Tirana i ka dhënë përparësi ndërtimit të kurrikulave, strukturës së programeve e diversitetit të diplomave e profileve në funksion të kërkesave të tregut të punës. Këtë gjë Universiteti Metropolitan Tirana e ka bërë edhe nëpërmjet ofrimit të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e të cilit është në përputhje me fushat e drejtimit akademike të UMT.</p> <p>Evidenca:</p>

	Aneksi Nr.01 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.03 Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf Aneksi Nr.53 Dosja e programit - BSC-IE-Te dhena te pergjithshme.pdf Aneksi Nr.56 Plan programet syllabuset e programit Bch Informatike Ekonomike.pdf			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Mbështetur tek dokumentat strategjike të Universitetit Metropolitan Tirana, Plani Strategjik Nr.224/1 datë 08.04.2019, GVJ konstaton se Universiteti Metropolitan Tirana ka si mision profilizimin e Universitetit Metropolitan Tirana në fushat e shkencave të aplikuara, inxhinjerisë dhe ekonomisë, duke i dhënë përparësi ndërtimit të kurrikulumeve, strukturës së programeve e diversitetit të diplomave e profileve në funksion të kërkesave të tregut të punës.</p> <p>Sipas Planit Strategjik për Zhvillimin e Programit, objektivat kryesore te programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në tërësinë e tyre synojnë të përgatisë specialistë “liderë të mendimit dhe të veprimit” të profilit të Informatikës Ekonomike, që synon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Transmetimit të njohurive teknologjike dhe aftësive praktike të bazuara në metodat dhe parimet shkencore. 2. Ngulitjes së qëndrimeve etike, sensit të profesionalizmit dhe aftësive të lidërshipt, të cilat kontribuojnë në zhvillimin teknologjik. 3. Përfitimit të aftësive për të analizuar dhe zgjidhur probleme në punën në grup dhe individuale si dhe të aftësive për të vlerësuar dhe për të marrë vendime në mënyrë krijuese duke u bazuar në evidenca dhe eksperiencë. 4. Zhvillimit të shprehive dhe aftësive individuale për të bërë analiza në fushat e kërkimit. 5. Zhvillimit dhe përvetësimit të njohurive dhe aftësive për të mësuar gjatë gjithë jetës, që janë thelbësore për përditësimin e vazhdueshëm të njohurive dhe aftësive, të cilat duhet të shkojnë paralel me zhvillimet bashkëkohore në njohuritë globale në kuadër të një shoqërie. 6. Njëpërmjet parashtrimit të problemeve dhe çështjeve të praktikës ekonomike, të cilat janë tepër të rëndësishme për politikën e institucioneve ekonomike dhe financiare të vendit dhe rajonit, për periudhën e tanishme dhe për të ardhmen. <p>Gjithashtu programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike ju jep studentëve njohuritë bazë formuese në fushat e bazave të të dhënave, programimit, multimedias, ekonomisë, etj, me objektiv</p>

	<p>kryesor formimin e specialistëve të informatikës së aplikuar në biznes dhe realizimin e studimeve të avancuara në këtë fushë.</p> <p>GVJ konstaton se dijet që marrin studentët në përfundim të këtij programi studimi në fusha të tilla si gjuhët e programimit, arkitektura e kompjuterave, sistemet e operimit, algoritmikë, strukturë të dhënash të kombinuara me njohuritë në fusha të tjera si statistikë, ekonometri, matematikë e zbatuar në ekonomi, mikroekonomi, makroekonomi e karakterizojnë profilin e tij.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.01 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.03 Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf Aneksi Nr.53 Dosja e programit - BSC-IE-Te dhena te pergjithshme.pdf Aneksi Nr.58 Rregullore programi informatika ekonomike.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Në bazë të dokumentave të shqyrtuara si dhe nga bisedat e zhvilluara me drejtuesit e institucionit, GVJ konstatoi se Universiteti Metropolitan Tirana ka zhvilluar një studim të tregut të punës përpara hapjes së këtij programi studimi, i bazuar tek të dhëna të marra nga fokus grupet, intervistat dhe anketimet, mbi bazë të të cilave ka qartësuar elementët bazikë të programit të studimit, emërtimin e programit, profilet, si dhe mundësitë për punësimin e të diplomuarve.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.74 Studim tregu per programin e Studim Bach-Informatikë Ekonomike.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënimit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Sipas Rregullores të Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Informatikë Ekonomike, struktura e këtij programi studimi është e organizuar në 5 kategori të lëndëve formuese. Ky program studimi përgatit studentë me njohuri bazë në drejtimin ekonomik dhe informatikë, duke ju siguruar atyre mundësi punësimi si specialistë ekonomie me njohuri në fushën e informatikës apo informaticien me njohuri në fushën e ekonomisë.</p> <p>Objektiv i këtij programi është përgatitja e specialistëve të informatikës të aftë në implementimin e sistemeve teknologjike për zgjidhjen e problemeve ekonomike. Për realizimin e këtij objektiv i në program janë përfshirë lëndë të tilla si: Arkitektura e Kompjuterit, Algoritmikë dhe Hyrje në Programim, Strukturë të Dhënash, Programim 1, Programim 2 të kombinuara me lëndët nga fusha e ekonomisë.</p> <p>Nga ana tjetër për të garantuar që dijet e përfituara i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve, institucioni ka kryer takime frekvente ku ka ndarë me ish studentët mendimet mbi përvojat e tyre personale në tregun e punës dhe ka kërkuar sugjerime e përshtypje për ndryshime, reformime e përmirësime të mundshme.</p>

	Evidenca: Aneksi Nr.74 Studim tregu per programin e Studim Bach-Informatikë Ekonomike.pdf Aneksi Nr.58 Rregullore programi informatika ekonomike.pdf Aneksi Nr.22 UMT Lista e marrëveshjeve në kuadër të programeve të FE.pdf			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4	
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	<p>Programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike është ofruar që nga viti 2011 nga Fakulteti Ekonomik i Universitetit Metropolitan Tirana.</p> <p>GVJ u informua gjatë bisedave me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi se institucioni ofron kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e këtij programi studimi duke marrë në konsideratë bashkëpunimin e departamenteve. Gjatë vitit 2020 – 2021 për realizimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike janë angazhuar 8 pedagogë si personel akademik efektiv (PAE) dhe 7 pedagogë me kontratë (PAK), si dhe 1 personel ndihmës akademik. Titujt dhe gradat e personelit akademik janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3 pedagogë me titullin akademik Profesor; - 1 pedagog me titullin akademik Profesor i Asociuar; - 5 pedagogë me gradën Doktor; - 2 pedagog në proces doktorature; - 4 pedagogë me kualifikimin MSc. <p>Evidenca:</p> <p>Tabela 12.1 Të dhëna për mbulimin e lëndëve me personel akademik Aneksi Nr.66 Lista e plote e PA me kohe te plote e te pjesshme FE-Tab. Nr. 2.pdf Aneksi Nr.66 Lista e plote e PA me kohe te plote e te pjesshme FE-Tab. Nr. 2.pdf</p>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit	Programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike ofrohet nga Departamenti i Informatikes Ekonomike si njësi bazë përgjegjëse nën drejtimin e Fakultetit të Ekonomisë si njësi kryesore, por duke vijuar bashkëpunimin me Departamente të tjera të fakultetit.

të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Duke u mbështetur tek dokumentat e vënë në dispozicion nga institucioni për strategjinë e kërkimit shkencor GVJ konstatoi se direktivat dhe udhëzimet kombëtare evropiane plotësohen.			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Evidenca: Aneksi Nr.73 Raport Vjetor FE PER MINISTRINE 2019-2020.pdf Aneksi Nr.53 Dosja e programit - BSC-IE-Te dhena te pergjithshme.pdf			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, është përgjegjës Departamenti i Informatikës Ekonomike, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë. Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucioni (Rregullore e Universiteti Metropolitan Tirana) GVJ është i mendimit se Universiteti Metropolitan Tirana ka siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit. Evidenca: Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.02 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf Aneksi Nr.01 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	GVJ ka konstatuar se institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit si dhe aktorët e biznesit vendas (p.sh. Universita degli Studi de Messina, Universita Politecnica delle Marche, Shoqërinë Bursa Shqiptare e Titujve ALSE SH.A., Universitetin e Tiranës, etj) bazuar kjo tek dokumentat e vëna në dispozicion të tilla si: Raporti vjetor, Viti Akademik 2019 – 2020; Lista e Marrveshjeve në Kuadër të Programeve të FE, etj. Evidenca: Aneksi Nr.23 Lista e marreveshjeve ne kuader te programeve te fe.pdf Aneksi Nr.73 Raport Vjetor FE PER MINISTRINE 2019-2020.pdf

<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Duke u bazuar tek dokumentat e vëna në dispozicion (Raporti vjetor, Viti Akademik 2019 – 2020; Projekti Promovimi i ekselencës në shkollat e Tiranës, UEEED: Universities Entrepreneurship Education Ecosystem Development, etj.; Ndërkombëtarizimi; Raporti i Përfitimeve nga Marrëveshjet e Bashkëpunimit) GVJ mendon se njësia përgjegjëse për këtë program ka hartuar në mënyrë periodike raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të këtij programi studimit.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.23 Lista e marreveshjeve ne kuader te programeve te fe.pdf Aneksi Nr.124 Programi i praktikës informatika ekonomike.pdf Aneksi Nr.28 Lista e Shkembimeve nderkombetare UMT.pdf</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Në bazë të Rregullores së Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Informatikë Ekonomike praktika profesionale e studentëve organizohet, ndiqet dhe mbikëqyret nga Përgjegjësi i Departamentit përkatës. UMT ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me disa institucione për kryerjen e praktikave profesionale.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.23 Lista e marreveshjeve ne kuader te programeve te fe.pdf Aneksi Nr.58 Rregullore programi informatika ekonomike.pdf</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ofron trajnime profesionale për studentët. Gjithashtu nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, Lista e Marëveshjeve të Bashkëpunimit, evidentojmë që ofrohen prej tyre trajnime ose intership-e.</p> <p>Aneksi Nr.23 Lista e marreveshjeve ne kuader te programeve te fe.pdf</p>			
<p>Shkalla e pëmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	----------------------	-----------------------------	----------------------------	---



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>GVJ konstatoi në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga institucioni (RVB; Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana, Neni 1 Baza Ligjore, Neni 22 Forma e studimit; Kurrikula e Programit; Plani Mësimor, etj) se studimet në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, janë si rregull me kohë të plotë, të organizuara në module ose lëndë dhe të shprehura në kredite përkatësisht 60 kredite në vit (në total 180 kredite), sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS), në frymën e Kartës së Bolonjës.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.54 Plani mësimor.pdf Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Sipas dokumentave, Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Informatikë Ekonomike i ofron studentëve mundësinë e përfitimit të njohurive teorike dhe aftësi praktike në ekonomiks, financë, kontabilitet, programim, rrjeta kompjuterike dhe në modelimin e proceseve të biznesit dhe të të dhënave të ndryshme. Me anë të këtij formimi ata do të kenë mundësi të punojnë si programues, specialistë të aplikimeve të web, dhe mund të implementojnë edhe rrjetat kompjuterike. GVJ konstaton se kjo gjë mbështetet tek kurrikula e programit.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Në bazë të dokumentave parimi themelor i ndërtimit të programit të lëndës për këtë program studimi është: 20% të programit e zënë njohuritë bazë dhe konceptet e lëndës; 65% të programit e zënë njohuritë e thelluara, të aplikuar dhe krahasuese në lëndë; 16% e zënë analiza dhe kritika e teorisë dhe aplikimeve të fushës. Literatura e lëndëve ka kryesisht karakter gjithëpërfshirës.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.54 Plani mësimor.pdf Aneksi Nr.55 Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E).pdf</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ duke u bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion konstaton se objektivi kryesor i programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike është t'u japë studentëve njohuritë bazë formuese në fushën e bazave të të dhënave, programimit, multimedias, etj me objektiv kryesor formimin e specialistëve të informatikës së aplikuar në biznes. Për realizimin e këtij objektivi programi parashikon studime në fusha të tilla bazë si gjuhët e programimit, arkitektura e kompjuterave, sistemet e operimit, algoritmikë, strukturë të dhënash, etj, të kombinuara me njohuritë në fusha të tjera si statistikë, ekonometri, matematikë e zbatuar</p>

	<p>në ekonomi, mikroekonomi, makroekonomi, etj. Gjithashu parimi themelor i ndërtimit të programeve të lëndëve është që 85% ta zënë njohuritë bazë dhe ato të thelluara. Në këtë aspekt GVJ është i mendimit se kryesisht ky program studimi zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca bazë në fushën e tij të studimit.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.54 Plani mësimor.pdf Aneksi Nr.55 Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E).pdf Aneksi Nr.56 Plan programet syllabuset e programit Bch Informatike Ekonomike.pdf</p>			
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Duke u mbështetur tek dokumentacioni i vënë në dispozicion GVJ konstatoi se në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në përputhje me to Universiteti Metropolitan Tirana ka hartuar dokumentat e tij, të tillë si “Rregullore e UMT” dhe “Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, të cilat përcaktojnë strukturën e programit të studimit me të gjithë elementët e tij.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.58 Rregullore programi informatika ekonomike.pdf</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Duke u mbështetur tek dokumentat e vëna në dispozicion GVJ konstatoi se ky program studimi i ka të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese të grupuara sipas kategorive dhe me ngarkesën përkatëse në kredite përkatësisht:</p> <p>Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kategoria A: Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme, 5 lëndë (30 ECTS). • Kategoria B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore, 16 lëndë (99 ECTS). • Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje, 4 lëndë (24 ECTS). • Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale, 5 lëndë (21 ECTS). • Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës ose provim i përgjithshëm formues, (6 ECTS). <p>Evidenca: Aneksi Nr.58 Rregullore programi informatika ekonomike.pdf Aneksi Nr.54 Plani mësimor.pdf Aneksi Nr.55 Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E).pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>



Standardi II.2**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike ofrohet nga Departamenti i Informatikës Ekonomike si njësi bazë, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, si njësi kryesore, në Universiteti Metropolitan Tirana. Duke u mbështetur tek dokumentat: Rregullore e UMT; Rregullore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor Informatikë Ekonomike, GVJ është i mendimit se njësi kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.58 Rregullore programi informatika ekonomike.pdf Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Për këtë program studimi koordinatori / Këshilltari Akademik është caktuar me anë të Vendim Nr.5, datë 27.04.2020, të Dekanatit të Fakultetit të Ekonomisë. Koordinator është pedagog që mban titullin akademik MSc. Ai është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale. Detyrat kryesore të Këshilltarit Akademik përcaktohen në aktet rregullatore të Universiteti Metropolitan Tirana.</p> <p>Në bazë të dokumentacionit të paraqitur GVJ konstatoi se detyrat e koordinatorit të programit janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e UMT ku evidentohet që ai raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.39 Përshkrimi Analitik i vendit të punës përgjegjës të programit të studimit.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>GVJ konstaton se Rregullorja e Universiteti Metropolitan Tirana dhe Statuti i Universiteti Metropolitan Tirana janë hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në përputhje me të gjitha vendimet, aktet ligjore e nënligjore në fuqi. GVJ është i mendimit se njësi kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike bazuar kjo tek dokumentat e shqyrtuara të vëna në dispozicion (Rregullore e Universiteti Metropolitan Tirana, Neni 1; Statuti i Universiteti Metropolitan Tirana, Neni 58, Neni 64).</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.01 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.51 Struktura-Organigrama e FE.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për</p>	<p>Në bazë të Urdhërit nr. 195 datë 01.04.2019, Fakulteti i Ekonomisë, përgjegjës për këtë program studimi, përbëhet nga 3 njësi bazë, në përputhje me kërkesat ligjore. Këto njësi bazë janë:</p>

<p>numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Shkencave Administrative • Departamenti Financë Bankë • Departamenti i Informatikës Ekonomike <p>Departamenti i Informatikës Ekonomike si njësi përgjegjëse për këtë program studimi përmbush kërkesën e ligjit për numrin e PAE (të paktën shtatë anëtarë) dhe raportin me PAK. Departamenti i Informatikës Ekonomike përbëhet nga 8 pedagogë të brendshëm dhe 7 pedagogë të jashtëm dhe raporti i mësimdhënies është 84% PAE dhe 16% PAK që japin mësim në këtë program studimi, bazuar tek dokumenti “Tabela përmbledhese: Të dhëna për mbulimin e lendeve me personel akademik Bachelor në Informatikë Ekonomike, 2020 – 2021”. Përkatësisht numri i PAE është 8 pedagogë nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Prof. Dr., - 1 Prof. Asoc. Dr., - 3 Dr. - 3 Msc. <p>Numri i PAK është 7 pedagogë nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 Prof Dr. - 2 Dr. - 3 Msc <p>Evidenca: Aneksi Nr.66 Lista e plote e PA me kohe te plote e te pjesshme FE- Tab. Nr. 2.pdf</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>GVJ konstaton se Rregullorja e Universiteti Metropolitan Tirana dhe Statuti i Universiteti Metropolitan Tirana janë hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në përputhje me të gjitha vendimet, aktet ligjore e nënligjore në fuqi. GVJ është i mendimit se njësi kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike bazuar kjo tek dokumentat e shqyrtuara të vëna në dispozicion (Rregullore e Universiteti Metropolitan Tirana, Neni 1; Statuti i Universiteti Metropolitan Tirana, Neni 58, Neni 64).</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.01 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.51 Struktura-Organigrama e FE.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ evidentoi se njësia kryesore dhe njësia bazë që janë përgjegjëse për këtë program studimi disponojnë të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit. Këto informacione gjenden në dokumentat e mëposhtëme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullore e Universiteti Metropolitan Tirana; • Rregullore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Informatikë Ekonomike; • Kurrikula e Programit Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Informatikë Ekonomike; • Plani Mësimor i Programit Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Informatikë Ekonomike. <p>Gjatë vizitës në institucion studentët na informuan që të gjithë informacionin e nevojshme në lidhje me programin e studimit dhe lëndët i marrin nëpërmjet syllabuseve të lëndëve dhe materialeve që hidhen në sistemin Edu4schools.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.53 Dosja e programit - BSC-IE-Te dhena te pergjithshme.pdf Aneksi Nr.58 Rregullore programi informatika ekonomike.pdf Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.54 Plani mësimor.pdf Aneksi Nr.55 Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E).pdf</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Institucioni ka përcaktuar në dokumentin “Rregullore e Universiteti Metropolitan Tirana, Neni 6” në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi rregullat e organizimit të të gjitha programeve të studimit.</p> <p>Në përputhje me këtë rregullore, dokumenti “Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Informatikë Ekonomike: Pika 9. Struktura e Programit të studimit” përcakton qartë lëndët, modulet, praktika dhe aktivitetet formuese të këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Ndarja specifike është e pasqyruar tek Plani Mësimor të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Informatikë Ekonomike” nga të cilat kemi:</p> <p>Veprimtaritë formuese në këtë program studimi grupohen në 5 kategori:</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Kategoria A: Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme, 5 lëndë (30 ECTS). • Kategoria B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore, 16 lëndë (99 ECTS). • Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje, 4 lëndë (24 ECTS). • Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale, 5 lëndë (21 ECTS). • Kategoria E: Detyrime përmblylëse – punimi i diplomës ose provim i përgjithshëm formues, (6 ECTS). <p>GVJ konstatoi se Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës dhe evropian, të ndara në vite</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423


Web site: www.ascal.al

Faqe 18


	<p>e semestra. Kreditet e një disipline fitohen vetëm pas vlerësimit të studentit me notë kaluese, kjo e përcaktuar në Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Informatikë Ekonomike: Pika 16.</p> <p>Në bazë të dokumentit Plani Mësimor i Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Informatikë Ekonomike GVJ konstatoi se në të gjenden të gjitha informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Informacione të tjera të nevojshme në lidhje me këtë program studimi, të tilla si, frekuentimi/ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve, etj., janë të paraqitura në “Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Informatikë Ekonomike pika 16 dhe 24, si dhe në Rregulloren e Universiteti Metropolitan Tirana, Kreu III.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.53 Dosja e programit - BSC-IE-Te dhena te pergjithshme.pdf Aneksi Nr.58 Rregullore programi informatika ekonomike.pdf Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.54 Plani mësimor.pdf Aneksi Nr.55 Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E).pdf</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ bazuar tek shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion evidentoi se nëpërmjet Rregullores së Universiteti Metropolitan Tirana Kreu III dhe Statutit të Universiteti Metropolitan Tirana Neni 68 dhe Neni 72 përcaktohen kriteret e pranimit dhe transferimit të studentëve sipas legjislacionit në fuqi duke i orjentuar studentët specifikisht sipas rregullores së programit të studimit përkatës.</p> <p>Kriteret e pranimit dhe transferimit dhe ekuivalentimit të studentëve për këtë program studimi përcaktohen në dokumentin Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Informatikë Ekonomike Pika 21 dhe Pika 22; Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.58 Rregullore programi informatika ekonomike.pdf Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ evidentoi që të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara gjenden qartësisht të shprehura në dokumentin Plani Mësimor i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në Informatikë Ekonomike. Gjithashtu ky program studimi përmban syllabuset e detajuara për secilën lëndë ku gjenden informacionet e nevojshme për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, etj, në përputhje me formatet e miratuara.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.54 Plani mësimor.pdf Aneksi Nr.55 Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E).pdf Aneksi Nr.56 Plan programet syllabuset e programit Bch Informatike Ekonomike.pdf Aneksi Nr.53 Dosja e programit - BSC-IE-Te dhena te pergjithshme.pdf</p>

<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Rregullorja e Universitetit Metropolitan Tirana Neni 26 përcaktojnë që lëndët dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program, si dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike. Sipas kësaj rregulloreje ndryshimet propozohen nga Departamenti, por edhe nga anëtarë të personelit akademik, në konsultim me ekspertë të fushës, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme. Ai shqyrtohet në Departament dhe dërgohet për miratim në mbledhjen e Dekanatit.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.56 Plan programet syllabuset e programit Beh Informatike Ekonomike.pdf, tabela 11 – Nryshimet në planin mësimor krahasuar me programet e licensuara</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.4 Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ evidentoi se ngarkesa dhe struktura e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi në Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Informatikë Ekonomike, Neni 3, dhe Neni 9.</p> <p>Përcaktimet specifike për strukturën dhe kreditet e këtij programi studimi jepen në Planin Mësimor të Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Informatikë Ekonomike përkatësisht ngarkesa në orë mësimore në auditor, si dhe puna individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Studenti që ndjek këtë program studimi duhet të marrë së paku 180 ECTS.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.58 Rregullore programi informatika ekonomike.pdf Aneksi Nr.57 Ngarkesa në auditor sipas formës së mësimdhënies-Tabela nr. 4 dhe tabela 13.pdf eksi Nr.89 Orari FE Bachelor sem 1 dhe Orari sem 2 bsc fakuleti i ekonomise.pdf Aneksi Nr.56 Plan programet syllabuset e programit Beh Informatike Ekonomike.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave</p>	<p>GVJ është i mendimit që kurrikula e programit të studimit në përgjithësi është një kurrikul që i përgjigjet qëllimit dhe objektivave të programit të studimit. Shpërndarja e lëndëve dhe praktikave i mundësojnë studentëve</p>



mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	të këtij programi studimi rritjen e aftësive profesionale dhe punësimin e tyre. Objektivi kryesor i programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike është t'u japë studentëve njohuritë bazë formuese. Kjo gjë mbështetet edhe në dokumentat e shqyrtuara. Evidenca: Aneksi Nr.54 Plani mësimor.pdf Aneksi Nr.53 Dosja e programit - BSC-IE-Te dhena te pergjithshme.pdf
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	GVJ konstatoi se ky program studimi ofrohet në 3 vite mësimore, gjithsej 6 semestra me kohëzgjatje normale 15 javë/një semestër, dhe në përfundim të tij studentët marrin 180 kredite (ECTS). Shpërndarja e lëndëve në semestra dhe shpërndarja e krediteve sipas lëndëve bën të mundur arritjen e objektivave formues të këtij programi studim dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe arsimit profesional (Rregullore Mësimore e Programit të studimit, Neni 5 dhe Neni 13; Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Evidenca: Aneksi Nr.54 Plani mësimor.pdf Aneksi Nr.58 Rregullore programi informatika ekonomike.pdf
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	GVJ konstatoi në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion por edhe gjatë bisedave me drejtuesit, pedagogët dhe studentët që struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit. Në këtë program studimi parimi themelor i ndërtimit të programit të lëndës është parimi i rrathëve ku 71.67% të programit e zënë njohuritë bazë dhe konceptet e lëndës 13.3% të programit e zënë njohuritë e thelluara, të aplikuara dhe krahasuese në lëndë dhe 15% e zënë analiza dhe kritika e teorisë dhe aplikimeve të fushës. Evidenca: Aneksi Nr.54 Plani mësimor.pdf Aneksi Nr.58 Rregullore programi informatika ekonomike.pdf
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori, në përputhje me përcaktimet ligjore. Institucioni synon që zhvillimi i kurrikulave të programit t'i referohet praktikave më të suksesshme ndërkombëtare, me qëllim rritjen e përputhshmërisë së tyre me kurrikulat në universitetet përëndimore, për të lehtësuar transferimin e studimeve dhe njohjen e krediteve, dhe për të rritur mundësitë e bashkëpunimit me universitetet partnere për programe të përbashkëta studimi, ose dhënien e diplomave të dyfishta. Bazuar tek sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre edhe vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë, duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale. Evidenca: Aneksi Nr.124 Programi i praktikës informatika ekonomike.pdf
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Rregullore E Universitetit Metropolitan Tirana, Neni 26 përcakton që syllabuset e lëndëve përditësohen çdo vit akademik. Propozimi për ndryshime bëhet nga pedagogët e lëndës, njësia përgjegjëse për zhvillimin e programit, dhe diskutimeve në mbledhjet e departamentit, etj.

	Gjithashtu sipas Rregullores së Universiteti Metropolitan Tirana dhe bisedave me NJBSC, GVJ konstatoi se literatura e detyruar dhe ndihmëse i përket viteve të fundit. Evidenca: Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	GVJ kostaton në bazë të dokumentave se sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre vazhdiminë studimeve të ciklit të dytë, duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale, por edhe punësimin e tyre direkt në përputhje me kërkesat e tregut.			
Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Evidenca: Aneksi Nr.54 Plani mësimor.pdf Aneksi Nr.55 Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E).pdf Aneksi Nr.56 Plan programet syllabuset e programit Bch Informatike Ekonomike.pdf			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	GVJ konstatoi në bazë të vizitës së bërë në institucion dhe Rregullores së Universitetit Metropolitan Tirana, Neni 26 se programi i studimit, plani mësimor, lëndët dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program, si dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike. Ndryshimet propozohen nga Departamenti dhe nga anëtarë të personelit akademik në bashkëpunim me ekspertë të fushës me të cilët UMT bashkëpunon. Evidenca: Aneksi Nr.22 UMT Lista e marrëveshjeve në kuadër të programeve të FE.pdf			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme i angazhuar në këtë program studimi i përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të përcaktuara në Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana Neni 11 dhe janë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë.
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të	Për realizimin e programit mësimor, specifikisht për vitin akademik 2020 – 2021, departamenti përgjegjës angazhoi personel akademik jo vetëm të vetëm departamentit por bashkëpunoi edhe me departamente të tjera.

<p>kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Numri total i personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi është 22, nga të cilët 15 janë Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 7 janë Personel Akademik me Kontratë (PAK), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3 pedagogë me titullin Prof. Dr. - 2 pedagogë me titullin Prof. Asoc. Dr. - 9 me titullin Dr. - 8 pedagogë me Master Shkencor (nga të cilët 4 në proces Doktorature) <p>Rezultoni stafi PAE është mbi 53% ndaj atij PAK por raporti i oreve ne auditor per stafin PAE eshte 84% ndaj atij PAK. Të gjithë kanë kualifikimin e nevojshëm dhe gradat shkencore sipas kërkesave të ligjit. “Tabela përmbledhëse të dhëna për mbulimin e lëndëve me personel akademik Bachelor në Informatikë Enokomike, 2020 – 2021”.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GJV u njoh me disa kontrata pune të pedagogëve efektivë dhe me kontratë.</p> <p>Në pjesën më të madhë të tij personeli akademik efektiv dhe me kontratë ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik që kërkon ligji si në drejtimin e programit të studimit edhe në zhvillimin e lëndëve përkatëse.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.31 Rregullore rekrutimi.pdf Aneksi Nr.61 CV te personelit.pdf Aneksi Nr.66 Lista e plote e PA me kohe te plote e te pjesshme FE- Tab. Nr. 2.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Informatikës Ekonomike, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë. Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi ka një nivel kualifikimi dhe fushën akademike-kërkimore që është në përputhje me natyrën e këtij programi studimi.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.61 CV te personelit.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Nëpërmjet nënshkrimit të një sërë marrëveshjes bashkëpunimi me kompani të njohura në vend, si 2LWEB Sh.p.k., Ikran Services CEO, European Alliance for Innovation (EAI), Ferar Shpk., C&S Construction, Raiffeisen Sh.A., NOA Shpk, etc., institucioni ka vënë në dispozicion personelin e mjaftueshëm dhe të kualifikuar për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale. Përsa i përket udhëheqjes së punimit të diplomës kjo bëhet kryesisht nga pedagogët efektivë, të cilët gjithashtu kanë kualifikimin e duhur në përshtatje me programin e studimit.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.22 UMT Lista e marrëveshjeve në kuadër të programeve të FE.pdf</p>

	Aneksi Nr.124 Programi i praktikës informatike ekonomike.pdf			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Në bisedat me drejtuesit dhe pedagogët e këtij programi studimi GVJ u informua që në ndihmë të këtij programi studimi është zyra e TI e cila ka dy punonjës, njëri prej të cilëve është në mbështetje të procesit mësimor dhe njëri merret vetëm me çështjet teknike që lidhen me laboratorët dhe mjediset e tjera mësimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, si dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni i ka kushtuar një rëndësi të veçantë përdorimit të metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies. Specifikisht programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike përdor metoda bashkëkohore të mësimdhënies, të cilat lidhen me përdorimin e kompjuterave dhe laboratorit në zhvillimin e lëndëve të ndryshme duke vendosur studentin në qendër të mësimin dhe më pranë praktikës.</p> <p>Institucioni ka zhvilluar gjithashtu trajnime për stafin akademik në lidhje me metodat inovative të mësimdhënies (dokumenti: Kurse trajnimi për teknikat e mësimdhënies - Projekti Bolonja). Gjatë vitit akademik 2020 – 2021 të zhvillimit të mësimin online, UMT i pajisi të gjithë studentët me laptop në mënyrë që ata të integroheshin sa më shpejt në platformat online të mësimdhënies. Gjithashtu u bë trajnimi i stafit akademik për përdorimin e shërbimeve Google education të tilla si: Google-Site dhe Google Classroom. Përveç metodave inovative në mësimdhënie institucioni përdor edhe platformën “edu4school” si një sistem të menaxhimit të informacionit në rang institucional. Ky sistem mbështet në të gjitha aspektet që lidhen me procesin e mësimin studentët dhe pedagogët.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.32 Kurse trajnimi per teknikat e mesimdhënies flipping classroom dhe Projekti Bolonja.pdf Aneksi Nr.103 Ndërfaqe classroom e një pedogagu.pdf Aneksi Nr.102 FE Raporti për metodat inovative në procesin e mësidhënies.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar (Statuti i UMT, Rregullore e NJSBC) GVJ konstaton se institucioni ka ngritur struktura që janë përgjegjëse për vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), është struktura kryesore përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Mekanizmat kryesorë që përdor NJSBC në këtë proces janë: pyetsori i studentëve për zhvillimin e mësimin dhe pyetsori i studentit për vlerësimin e kursit. Në përfundim të çdo semestri NJSBC zhvillon anketimin e studentëve nëpërmjet pyetsorëve të sipërpërmendur dhe harton Raportin e vlerësimin semestral dhe ja paraqet atë Senatit Akademik brenda 15 ditësh nga përfundimi i semestrit. Raporti përmban konkluzione dhe rekomandime të dhëna nga NJSBC në bazë të gjetjeve që janë nxjerrë nga përpunimi i të</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar (Statuti i UMT, Rregullore e NJSBC) GVJ konstaton se institucioni ka ngritur struktura që janë përgjegjëse për vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), është struktura kryesore përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Mekanizmat kryesorë që përdor NJSBC në këtë proces janë: pyetsori i studentëve për zhvillimin e mësimin dhe pyetsori i studentit për vlerësimin e kursit. Në përfundim të çdo semestri NJSBC zhvillon anketimin e studentëve nëpërmjet pyetsorëve të sipërpërmendur dhe harton Raportin e vlerësimin semestral dhe ja paraqet atë Senatit Akademik brenda 15 ditësh nga përfundimi i semestrit. Raporti përmban konkluzione dhe rekomandime të dhëna nga NJSBC në bazë të gjetjeve që janë nxjerrë nga përpunimi i të</p>

Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.

Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.

dhënave. Ky raport ju vihet në dispozicion njësisive bazë të cilat e analizojnë atë në mbledhjet e departamenteve.

GVJ u informua gjatë takimit me Përgjegjësën e Departamentit të Informatikës Ekonomike dhe Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë që ata i japin një rëndësi të veçantë anketimit të studentëve dhe përfshirjes së tyre në vlerësimin e procesit mësimor. Gjatë vizitës në institucion, GVJ diskutoi me studentët në lidhje me përfshirjen e tyre në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies dhe konfirmoi se ata ishin vërtet pjesë e rregullt dhe e vazhdueshme e këtij procesi. Ata pohuan që kërkesat apo sugjerimet e tyre në lidhje me procesin e mësimdhënies apo dhe të vlerësimit në provime merreshin në konsideratë rast pas rasti në përputhje me Rregulloren e UMT apo Rregulloren e Provimeve.

Përveç NJSBC një rol të rëndësishëm në monitorimin e procesit mësimor ka edhe departamenti. Përgjegjësi i Departamentit të Informatikës Ekonomike na informoi se në fillim të vitit akademik hartohet plani i punës për personelin akademik për vlerësimin e performances së pedagogut, në të cilin përfshihet përveç të tjerash edhe vlerësimi për mësimdhënien. Gjithashtu Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me NJSBC organizojnë kontrole periodike për mënyrën e zhvillimit të leksioneve direkt në auditor.

NJSBC funksionon në përputhje me Statutin e UMT dhe në bazë të Rregulloreve të NJSBC. Raporti periodik i vlerësimit që harton NJSBC dërgohet në Senat brenda 15 ditëve pas përfundimit të semestrit dhe pastaj i dërgohet drejtuesve të njësisive kryesore dhe njësisive bazë. Pas diskutimeve në dekanat dhe në mbledhjet e departamenteve ato bëhen publike edhe për studentët, të cilët njihen me problematikat e ngritura dhe masat që do të merren për ti adresuar ato.

GVJ u informua se ky proces ka sjellë shumë përmirësime jo vetëm në aspektin e mësimdhënies por edhe për çështje të tjera të ngritura nga studentët, në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës, etj. Në takimin me drejtuesit e UMT, u informuam që në mbledhjet ku analizohen rezultatet e anketimeve, diskutohen problematikat por edhe praktikave më të mira të evidentuara, duke i promovuar ato.

Evidenca:

Aneksi Nr.01 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf

Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf

Aneksi Nr.09 UMT Rregullore e NJSBC.pdf

Aneksi Nr.11 Model i pyetësorit për studentet.pdf

Aneksi Nr.11.1 Model i pyetësorit për studentet.pdf

Aneksi Nr.10 Raport i sem 1 njsbc.pdf

Aneksi Nr.120 UMT Rregullore e provimeve.pdf

Aneksi Nr.122 Shembull plan monitorimi për mesimdhënien FE-semestri parë-2020-2021.pdf

Aneksi Nr.115 Porcesverbal i kontrollit në auditor.pdf

Aneksi Nr.116 Minuta mbledhje departament Procesverbal Mbledhje FE.pdf

	Aneksi Nr.106 Kërkesa të ndryshme të Këshillit Studentor të FE.pdf Aneksi Nr.76 Minutat e një mbledhje stafi në FE.pdf Aneksi Nr.73 Raport Vjetor FE PER MINISTRINE 2019-2020.pdf			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Bazuar tek Rregullore e UMT Neni 27 si dhe Plani Mësimor i programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, GVJ konstaton se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve dhe njohurive të miratuara dhe të përdorura janë: leksionet/ seminarët/ laboratorët/ detyrat e grupit/ detyrat e kursit, etj.</p> <p>Sipas Planit Mësimor rezultojnë në auditor, përkatësisht sipas formave të mësimdhënies, në total orët e mëposhtëme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione 810 orë mësimore - Seminare 655 orë mësimore - Laboratore 70 orë mësimore - Gjithsej në auditor 1535 orë mësimore
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Siç është përmendur edhe në Standardin III.1 stafi akademik i UMT u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. Programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike përdor metoda bashkëkohore të mësimdhënies, të cilat lidhen me përdorimin e kompjuterave dhe laboratorit me synim konkretizimin e anës praktike dhe përmirësimin e aftësive programuese dhe përpunuese të studentëve. Në përgjigje në nevojave të studentëve është edhe pajisja e tyre me laptop për t'ju përshtatur sa më mirë procesit të mësimin online, por edhe për të pasur mundësi të praktikimit në shtëpi të njohurive të marra në auditor.</p> <p>Gjithashtu GVJ konstaton se institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike nëpërmjet seminareve, workshop-eve, trajnimeve të organizuara për këtë qëllim. Në këtë kuadër mund të përmendim kurset e trajnimit të Projektit Bolonja, apo shkëmbimet e stafit me projektet Erasmus+, të cilat i japin mundësi stafit akademik të fitojë eksperiencë të reja.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.54 Plani mësimor.pdf Aneksi Nr.56 Plan programet syllabuset e programit Bch Informatike Ekonomike.pdf Aneksi Nr.32 Kurse trajnimi per teknikat e mesimdhënies flipping classroom dhe Projektit Bolonja.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	

	Aneksi Nr.25 Marredheniet me jashte dhe projektet, Mobiliteti Akademik.pdf
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	<p>Bazuar tek dokumentacioni i shqyrtuar (CV e personelit akademik, Tabela 7 Stafit sipas kualifikimit) si dhe nga takimi me stafin akademik gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që UMT ka angazhuar një personel akademik shumë të kualifikuar, me eksperiencë profesionale kombëtare dhe ndërkombëtare, fusha e tyre e studimit është në përputhje me lëndët që ata zhvillojnë, duke qenë në përmbushje të kërkesave ligjore dhe udhëzimeve të tjera në fuqi. Ata përdorin mjete bashkëkohore për mësimdhënien sipas tematikave të lëndëve të tyre.</p> <p>Në bazë të Tabelës 7: Stafit sipas kualifikimit, gjatë vitit 2020 – 2021 për realizimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike janë angazhuar 15 pedagogë si personel akademik efektiv (PAE) dhe 7 pedagogë me kontratë (PAK), si dhe 1 personel ndihmës akademik. Titujt dhe gradat e personelit akademik janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3 pedagogë me titullin Prof. Dr. - 2 pedagogë me titullin Prof. Asoc. Dr. - 9 me titullin Dr. - 8 pedagogë me Master Shkencor (nga të cilët 4 në proces Doktorature) <p>Evidenca:</p> <p>Tabelat Permbledhese.pdf – Tabela 7 Aneksi Nr.61 CV te personelit.pdf</p>
Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Gjatë vizitës në institucion, në takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ u informua se personeli akademik është gjithmonë i fokusuar tek përmirësimi i metodave të mësimdhënies. Në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, personeli përballet me kërkesat apo sugjerimet e studentëve për procesin mësimor nëpërmjet raporteve periodike që harton NJSBC. Gjithashtu edhe Këshilltarët Akademik kanë një rol aktiv në përcjelljen tek pedagogët, të mendimeve dhe sugjerimeve të studentëve për përmirësimin e formave të mësimdhënies.
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Në takimin me drejtuesit, por edhe pedagogët, e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, GVJ u informua që synimi i institucionit është që të promovojë metodat e reja të mësimdhënies me në qendër studentin, duke i dhënë më shumë mundësi pjesëmarrjes aktive të tyre, apo edhe punës së pavarur dhe zhvillimit dhe aplikimit të njohurive në laborator. Eksperiencë profesionale e stafit akademik si dhe projektet e shkëmbimit me bursat Erasmus+ kanë përmirësuar shumë metodat e mësimdhënies në UMT.
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Duke pasur si synim studentin në qendër, përdorimi i formave të reja të mësimdhënies inkurajon të menduarin e pavarur dhe kritik nga ana e studentëve si dhe i bën ata më të hapur dhe të aftë të artikulojnë lirisht opinionet e tyre. GVJ u informua nga studentët se një ndër format e mësimdhënies të zbatuara nga pedagogët ishte nxitja e studentëve që të merrnin pjesë aktive gjatë procesit mësimor dhe të zhvillonin projekte kursi

	<p>të pavaruara. Kështu studentët promovohen që të fitojnë aftësi shprehëse dhe argumentuese edhe në debatin mes njëri - tjetrit.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.10 Raport i sem I njsbc.pdf Aneksi Nr.123 Vendim i fe keshilltare akademike dhe Axhenda e Këshilltarve Akademik.pdf Aneksi Nr.106 Kërkesa të ndryshme të Këshillit Studentor të FE.pdf Aneksi Nr.49 Udhëzimi mbi mësimdhënien në distancë.pdf Aneksi Nr.25 Marredheniet me jashte dhe projektet, Mobiliteti Akademik.pdf</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe tek vizita në mjediset e Universitetit “Metropolitan Tirana”, GVJ konstaton se veprimtaria akademike e UMT realizohet në mjedise moderne, me hapësira të bollshme dhe të pajisura me mjete të teknologjisë së fundit të informacionit. Përkatësisht këto hapësira përbëhen nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Godina 1 me sipërfaqe 2347 m² dhe Godina 2 me sipërfaqe 2490 m², që ofrojnë një infrastrukturë moderne, komode dhe të përshtatshme për grupet mësimore të këtij programi studimi dhe numrin e studentëve në to. Në 2 godinat e UMT gjenden 8 salla leksionesh, 17 salla seminaresh, 6 laboratorë informatike dhe biblioteka. - Të gjitha mjediset në të dy godinat janë të pastra, me ndriçim dhe ajrosje, me sistem ngrohje / ftohje, me standarde moderne. - Auditorët janë të pajisur me PC, videoprojektor, dhe akses në internet wireless. - UMT përdor platformën “edu4school” e cili ka një strukturë modulare që krijon mundësinë e menaxhimit të integruar të të dhënave të programeve akademike, të personelit, të studentëve. Ky sistem menaxhon në kohë reale lidhjen midis studentëve, pedagogëve, sekretarisë. - Studentët dhe pedagogët janë të pajisur me një adresë postare nga institucioni e cila mundëson komunikimin e shpejtë dhe efektiv pedagog-student dhe anasjelltas. <p>Evidenca:</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	

	<p>Aneksi Nr.107 Ambjentet për Infrastrukturën e programit Bsc ne IE.pdf</p> <p>Aneksi Nr.108 Mjediset dhe Asete infrastrukurore akademike - UMT-Tab-Nr.16.pdf</p> <p>Aneksi Nr.109 Bibloteka UMT INVENTARI.pdf</p> <p>Aneksi Nr.43 UMT Sistemi informatik i menaxhimit të studentëve.pdf</p> <p>Aneksi Nr.48 UMT Platforma për mësimin online.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabus-eve të lëndëve të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, GVJ konstatoi se në pothuajse të gjitha lëndët ofrohen tituj të larmishëm në literaturë (të detyrueshëm dhe të sugjeruar) për studentët. Tekstet janë në përgjithësi të autorëve të mirënjohur në fushat përkatëse të studimit. Gjatë takimit me studentët, GVJ u informua se literatura është e zgjeruar dhe atyre u vendosen në dispozicion nga ana e pedagogëve tekstet e plota elektronike kryesisht në gjuhën angleze, dhe materiale të përgatitura prej tyre në gjuhën shqipe. Gjithashtu edhe fondi i literaturës fizike në bibliotekë mbështet marrjen e dijeve të nevojshme në këtë program studimi.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok. 17. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.pdf</p> <p>Aneksi Nr.109 Bibloteka UMT INVENTARI.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion (Inventari i Bibliotekës së UMT) GVJ konstaton se biblioteka disponon në fondin e saj rreth 758 libra, si dhe një numër të konsiderueshëm revistash, cikël leksionesh dhe materiale të tjera në ndihmë të studentëve. <i>Megjithatë GVJ mendon se pavarësisht se institucioni ka bërë përpjekje të konsiderueshme për shtimin e literaturës në bibliotekë, në përmbushje të rekomandimeve të lëna në akreditimin e parë të këtij programi studimi, përsëri ka vend për shtimin e titujve të librave në literaturën fizike apo online, sidomos në gjuhën shqipe, për të mbështetur nevojat e programit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Gjithashtu është e nevojshme që të përditësohet literatura e bibliotekës me botime të viteve të fundit.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Mbështetur tek dokumentacioni i shqyrtuar (Të dhëna të plota për platformat online) GVJ konstaton se ka një numër të kufizuar mundësisish, përta i përket numrit të tyre, për të aksesuar bibliotekat online. GVJ u informua nga punonjësit e bibliotekës që institucioni ka zgjedhur të bëjë abonimin në bibliotekat online sipas kërkesave të departamenteve, në mënyrë që dhe shërbimi të jetë në përputhje me nevojat dhe fushën e tyre të studimit. Gjithashtu GVJ u informua që biblioteka së bashku me sektorin e TI po bashkëpunojnë për të dixhitalizuar materialet dhe botimet e ndryshme të literaturës së përdorur për programet e studimit për t’jua vënë në dispozicion studentëve online.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.109 Bibloteka UMT INVENTARI.pdf</p> <p>Tabelat Permbledhese.pdf – tabela 17</p>

<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Sikurse e kemi cilësuar edhe në kriteret më sipër UMT vë në dispozicion të Fakultetit të Ekonomisë, përgjegjës për këtë program studimi, 4 laboratorë informatike dhe 1 sallë interneti. Laboratorët janë të pajisur me programe kompjuterike në përputhje me specifikat e programit. Studentët i shfrytëzojnë në mënyrë të vazhdueshme laboratorët në funksion të procesit mësimor, në përgatitjen e detyrave të kursit, apo për praktikimin e njohurive të marra në leksione dhe seminare.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Gjithashtu UMT përdor platformën “edu4school” nëpërmjet të cilës realizohet i gjithë shkëmbimi i informacionit në mbështetje të procesit mësimor midis studentëve dhe pedagogëve.</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Studentët dhe pedagogët përdorin sistemin elektronik “edu4school” që është i disponueshëm për të gjithë strukturat e UMT. Ky sistem përdoret për të shkëmbyer informacionin midis pedagogëve dhe studentëve dhe strukturave të tjera të universitetit. Gjithashtu studentët dhe pedagogët janë të pajisur me një adresë postare nga institucioni (emër.mbiemër@umt.edu.al) e cila mundëson komunikimin e shpejtë dhe efektiv pedagog-student dhe anasjelltas.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.107 Ambjentet për Infrastrukturën e programit Bsc ne IE.pdf</p> <p>Aneksi Nr.108 Mjediset dhe Asete infrastrukurore akademike - UMT-Tab-Nr.16.pdf</p> <p>Aneksi Nr.43 UMT Sistemi informatik i menaxhimit të studentëve.pdf</p> <p>Aneksi Nr.48 UMT Platforma për mësimin online.pdf</p> <p>https://www.edu4schools.gr/Account/Login</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>GVJ kostaton se kriteret dhe procedurat e diplomimit në UMT përcaktohen në Rregulloren e UMT Kreu VII si dhe në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike Neni 15. Në to përcaktohet që diploma në përfundim të ciklit të parë të studimeve Bachelor mbrohet me provim formimi. GVJ u informua që aktualisht në programet e ciklit të parë Bachelor, diploma mbrohet kryesisht me provim formimi, ndërsa për studentët me mesatare mbi 8 me punim diplome. Në të dyja rastet studentët ndjekin udhëzimet dhe procedurat që publikon dekanati dhe departamenti, dhe kanë asistencën dhe mbështetjen maksimale të stafit akademik të ngarkuar për mbulimin e këtij aktiviteti.</p> <p>Pas hartimit të Draft RVJ nga GVJ, institucioni dorëzoi dhe u ngarkua në sistemin AMS të ASCAL, dokumenti “Vendim: Mbi disa rregulla lidhur me udhëheqjen dhe mbrojtjen e tezave të diplomave” datë 07.04.2021, të cilin GVJ e merr në konsideratë dhe bëri ndryshimet përkatëse në këtë kriter në përputhje me këtë dokument. Në këtë dokument gjenden modelitetet e procesit të diplomimit të studentëve me temë diplome, që nga caktimi i udhëheqësit, konsultimet, kontrolli anti-plagjaturë e deri tek faza e mbrojtjes së punimit.</p> <p>Evidenca:</p>

	<p>Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</p> <p>Aneksi Nr.58 Rregullore programi informatika ekonomike.pdf</p> <p>Aneksi Nr.63 FE Proçedura për zhvillimin e provimeve FE.pdf</p> <p>Aneksi Nr.120 UMT Rregullore e provimeve.pdf</p> <p>Vendim: Mbi disa rregulla lidhur me udhëheqjen dhe mbrojtjen e tezave të diplomave“ datë 07.04.2021</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar (Statuti i UMT, Rregullore e NJSBC) GVJ konstaton se institucioni ka ngritur struktura që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe koordinojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), është struktura kryesore përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Në përfundim të çdo semestri NJSBC zhvillon anketimin e studentëve nëpërmjet pyetësorëve dhe harton Raportin e vlerësimit semestral dhe ja paraqet atë Senatit Akademik brenda 15 ditësh nga përfundimi i semestrit. Ky raport ju vihet në dispozicion njëjësive bazë të cilat e analizojnë atë në mbledhjet e departamenteve.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.01 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.09 UMT Rregullore e Njsbc.pdf Aneksi Nr.11 Model i pyetësorit per studentet.pdf Aneksi Nr.11.1 Model i pyetësorit per studentet.pdf Aneksi Nr.10 Raport i sem 1 njsbc.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Sikurse e kemi përmendur edhe më sipër në këtë raport, përveç NJSBC një rol të rëndësishëm në monitorimin e procesit mësimor ka edhe departamenti. Përgjegjësi i Departamentit të Informatikës Ekonomike na informoi se në fillim të vitit akademik hartohet plani i punës për personelin akademik për vlerësimin e performances së pedagogut, në të cilin përfshihet përveç të tjerash edhe vlerësimi për mësimdhënien. Gjithashtu Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me NJSBC organizojnë kontrole periodike për mënyrën e zhvillimit të leksioneve në auditor.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e</p>	

<p>metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstaton gjithashtu se njësitë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike i japin një rëndësi të veçantë përdorimit të metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies, të cilat lidhen me përdorimin e kompjuterave dhe laboratorit në zhvillimin e lëndëve të ndryshme. Institucioni ka zhvilluar gjithashtu trajnime për stafin akademik në lidhje me përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies (dokumenti: Kurse trajnimi për teknikat e mësimdhënies - Projekti Bolonja).</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.122 Shembull plan monitorimi per mesimdhënien FE-semestri parë-2020-2021.pdf</p> <p>Aneksi Nr.115 Porcesverbal i kontrollit ne auditor.pdf</p> <p>Aneksi Nr.32 Kurse trajnimi per teknikat e mesimdhënies flipping classroom dhe Projekti Bolonja.pdf</p> <p>Aneksi Nr.103 Ndërfaqe classroom e një pedogagu.pdf</p> <p>Aneksi Nr.102 FE Raporti për metodat inovative në procesin e mësimdhënies.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Gjatë takimit në institucion me personelin akademik përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, GVJ u informua se UMT ofron angazhimin e vet për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit në fushën e kërkimit shkencor. Institucioni mbështet pjesëmarrjen e personelit në projektet kërkimore dhe mobilitetet e mundësuar prej ERASMUS+, si një mënyrë efektive për njohjen dhe përmirësimin e aftësive kërkimore dhe metodave të mësimdhënies. Gjithashtu UMT i ofron personelit mundësinë e trajnimeve të ndryshme nëpërmjet projektit Bolonja. GVJ konstaton gjithashtu se UMT mbështet financiarisht personelin akademik për pjesëmarrje në konferenca si dhe botime të artikujve në revista shkencore.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.03 Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf</p> <p>Aneksi Nr.73 Raport Vjetor FE PER MINISTRINE 2019-2020.pdf</p> <p>Aneksi Nr.25 Marredheniet me jashte dhe projektet, Mobiliteti Akademik.pdf</p> <p>Aneksi Nr.28 Lista e Shkembimeve nderkombetare UMT.pdf</p> <p>Aneksi Nr.32 Kurse trajnimi per teknikat e mesimdhënies flipping classroom dhe Projekti Bolonja.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të dokumentave të shqyrtuara se institucioni i mundëson stafit akademik trajnime në lidhje me përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie. Në bazë të dokumentave të shqyrtuara (Metodat inovative të mësimdhënies që përmirësojnë angazhimin e studentëve; Manuali i platformës së mësimin online) GVJ konstaton se trajnimet e stafit kanë konsistuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trajnime për implementimin e sistemit elektronik për përdorimin e platformës së menaxhimit të programit të studimit edu4schools. - Trajnime për shkrimin dhe aplikimin në projekte të kërkimit shkencor nga AKKSHI.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 33

	<ul style="list-style-type: none"> - Leksione të hapura nga lektorë të huaj. - Etj. <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.102 FE Raporti për metodat inovative në procesin e mësimdhënies.pdf</p> <p>Aneksi Nr.44 UMT Manual përdorimi të sistemit informatik të studentve.pdf</p> <p>Aneksi Nr.48 UMT Platforma për mësimin online.pdf</p> <p>Aneksi Nr.49 Udhëzimi mbi mësimdhënien në distancë.pdf</p> <p>Aneksi Nr.72 Lista e vizitave te stafit akademik te huaj ne UMT.pdf</p>			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	<p>Në bazë të informacioneve të marra në takimin me Përgjegjës të Departamentit të Informatikës Ekonomike dhe pedagogët e këtij programi studimi, GVJ konstaton se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Përgjegjësitë e stafit akademik dhe ndihmës akademik janë gjithashtu të përcaktuara në kontratën e punës dhe në rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, Neni 17.</p> <p>Gjithashtu GVJ konstaton se personeli akademik dhe ai ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në departament. Performanca e personelit akademik si dhe rezultatet e punës së tyre analizohen në mbledhjet periodike të departamentit si dhe në raportin periodik të NJSBC.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.50 FE Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf</p> <p>Aneksi Nr.10 Raport i sem I njsbc.pdf</p> <p>Aneksi Nr.102 FE Raporti për metodat inovative në procesin e mësimdhënies.pdf</p> <p>Aneksi Nr.71 FE Modeli i formularit të vlerësimit të Performacës.pdf</p>			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	<p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.50 FE Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf</p> <p>Aneksi Nr.10 Raport i sem I njsbc.pdf</p> <p>Aneksi Nr.102 FE Raporti për metodat inovative në procesin e mësimdhënies.pdf</p> <p>Aneksi Nr.71 FE Modeli i formularit të vlerësimit të Performacës.pdf</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstatoi se mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve përcaktohet në Rregulloren e UMT Kreu V, Rregulloren e Provimeve, Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë Neni 25. Këto dokumenta janë publike dhe lehtësisht të aksesueshme për studentët. <i>GVJ</i>

<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p><i>sugjeron publikimin e tyre edhe në faqen e web-it të UMT, meqënëse nuk ka evidence të këtyre rregulloreve në https://umt.edu.al/.</i></p> <p>Gjithashtu studentët njihen me mënyrat e vlerësimit dhe testimit nëpërmjet prezantimit të lëndës dhe të syllabus-eve në javën e parë të semestrit nga pedagogët e tyre. Syllabuset dhe materiale të tjera në lidhje me mësimin at ai kanë të disponueshme edhe në portalin e tyre https://www.edu4schools.gr/Account/Login. Gjithashtu informacione të detajuara studentët i marrin edhe në dosjen e regjistrimit të tyre në UMT.</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi i njohurive dhe aftësive të fituara realizohet nëpërmjet provimeve përfundimtare, provimeve të ndërmjetme, detyrave të shtëpisë, detyrave të kursit, ushtrimeve dhe punëve të laboratorit, etj. Të gjitha këto aktivitetet janë të parashikuara në syllabus-et e lëndëve.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.120 UMT Rregullore e provimeve.pdf Aneksi Nr.50 FE Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf https://umt.edu.al/ Aneksi Nr.56 Plan programet syllabuset e programit Bch Informatike Ekonomike.pdf https://www.edu4schools.gr/Account/Login</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Bazuar tek syllabuset e lëndëve si dhe tek informacionet e marra gjatë takimit me pedagogët dhe studentët, GVJ konstaton se vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm gjatë gjithë periudhës mësimore dhe vitit akademik dhe është rezultante e disa elementëve të shtrira gjatë gjithë vitit akademik të tilla si: provime të ndërmjetëm, teste të shkurtra, praktika, detyra, projekte, seminare, pjesëmarrje aktive, detyra laboratorit.</p> <p>Bazuar tek Programi i Lëndës (Tabelat 14 -Tabelat Përmbledhëse) vlerësimi i vazhduar konsiston në këta elementë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive 10% • Plotësimi i detyrimeve (lab/detyra kursi) 10% • Testim i ndërmjetëm 10% • Provimi përfundimtar 70% • Totali 100% <p>Kjo shpërndarje gjatë gjithë vitit / semestrit i jep mundësi studentëve të vlerësojnë gradualisht njohuritë e tyre dhe të plotësojnë boshllëqet që gjatë</p>


	<p>semestrin duke zvogëluar riskun që mund të sjellë vetëm një vlerësim përfundimtar.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.56 Plan programet syllabuset e programit Beh Informatike Ekonomike.pdf</p> <p>Tabelat Permbledhese.pdf – Tabela 14</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>UMT përdor sistemin elektronik “edu4school” në funksion të studentëve, pedagogëve dhe njësisve të tjera të institucionit. Ky sistem gjithashtu mundëson testimin dhe vlerësimin elektronik. Gjithashtu janë përdorur edhe platforma të tjera të tilla si Google Classroom. UMT përdor edhe testimin nëpërmjet formateve standarde të prituara dhe duke bërë korigjimin elektronik nëpërmjet Clean Score, duke ruajtur në këtë mënyrë anonimitetin. Këto forma kanë kontribuar në rritjen e transparencës dhe shmangien e abuzimeve në procesin e testimit dhe vlerësimit të studentëve.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.43 UMT Sistemi informatik i menaxhimit të studentëve.pdf https://www.edu4schools.gr/Account/Login</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit (Rregullore e UMT, Procedura të zhvillimit të provimeve) GVJ konstaton se testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës. Komisioni krijohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe miratohet nga Dekani. Teza e provimit hartohet nga titullari i lëndës gjithashtu në bashkëpunim me pedagogun që zhvillon seminarin, kur është një rast i tillë. Pasi hartohet, teza e provimit, firmoset nga titullari i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</p> <p>Aneksi Nr.63 FE Procedura për zhvillimin e provimeve FE.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Bazuar tek informacionet e marra gjatë vizitës në institucion si dhe tek dokumentacioni i shqyrtuar, GVJ konstaton se testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim. Mënyra e sekretimit përcaktohet në dokumentin “Procedura për zhvillimin e provimeve, pika 5”. Teza sekretohet nga sekretaria me barkod dhe kontrollohet nga pedagogu në mënyrë anonime. Provimi nuk zhvillohet asnjëherë pa sekretim, dhe monitorohet nga pedagogët dhe në disa salla ka edhe kamera sigurie. Njësitë përgjegjëse gjatë monitorimit shmangin tentativat për kopjim, raste të cilat bien ndesh me Rregulloren e UMT për zhvillimin e provimeve dhe Kodin e Etikës.</p> <p>Bazuar tek metoda e vlerësimit të vazhduar studentët kanë mundësi të marrin komentet dhe vlerësimet e pedagogut gjatë gjithë kohës gjë që i ndihmon në procesin e të nxënësve dhe përmirësimin deri në provimin përfundimtar. Edhe në provimin përfundimtar në korigjimin e tezave të</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Bazuar tek metoda e vlerësimit të vazhduar studentët kanë mundësi të marrin komentet dhe vlerësimet e pedagogut gjatë gjithë kohës gjë që i ndihmon në procesin e të nxënësve dhe përmirësimin deri në provimin përfundimtar. Edhe në provimin përfundimtar në korigjimin e tezave të</p>

<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>provimit, pedagogu komenton dhe evidenton të gjitha boshllëqet apo pyetjet e realizuara duke dhënë komentet përkatëse që mbështesin vlerësimin total.</p>			
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Teza e provimit është ndërtuar e tillë duke pasur në konsideratë nivele të ndryshme njohurish nga ato më të thjeshtat deri tek më të vështirat duke i dhënë mundësi studentëve të të gjitha niveleve të arrijnë rezultatin në përputhje me angazhimin e tyre. Tezat korrigjohen brenda një jave nga data e provimit, studentët marrin rezultatet dhe ju jepet mundësia e kontestimit të rezultatit apo rishikimit të korrigjimit brenda 48 orëve, sipas rregullave që përcakton Rregullorja e UMT dhe Rregullorja e Provimeve, Neni 17. Çdo kërkesë shqyrtohet nga komisioni fillestar i provimit, dhe nëse studenti nuk është i kënaqur ngrihet një komision tjetër me miratimin e dekanit. E gjithë procedura dokumentohet në departament.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në përfundim të procesit, teza së bashku me zgjidhjen depozitohet në departament.</p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</p> <p>Aneksi Nr.63 FE Procedura për zhvillimin e provimeve FE.pdf</p> <p>Aneksi Nr.15 UMT Rregullore e Etikës.pdf</p> <p>Aneksi Nr.120 UMT Rregullore e provimeve.pdf</p> <p>Aneksi Nr.105 Model Ankimi nga studentet e FE.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët,duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Mbështetur tek Programet e Lëndëve (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike si dhe në diskutimet me pedagogët dhe studentët, GVJ konstaton se gjatë zhvillimit të mësimin në këtë program përdoren metoda të cilat janë në funksion të thellimit të njohurive për studentët. Nëpërmjet leksioneve merren njohuritë bazë dhe ato më të thelluara, të cilat aplikohen në seminareve dhe labore ku studentët zhvillojnë aftësitë profesionale dhe nëpërmjet projekteve të kursit thellohen aftësitë analitike për zgjidhjen e problemeve. Programi i studimit është në përputhje me kornizën Shqiptare të kualifikimit niveli Nr. 6 përsa i përket njohurive që ofron nëpërmjet leksioneve, seminareve dhe praktikave profesionale.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	



	<p>Bazuar tek Plan Programet, ky program ka si qëllim të përgatisë profesionistë me njohuri mbi funksionimin e teknologjive të reja, përdorimin dhe krijimin e programeve kompjuterike në bazë të nevojave të tregut. Ti pajisë studentët me njohuri të thelluara lidhur me teorinë ekonomike dhe të menaxhimit të ndërmarrjeve, si dhe ti japë atyre formim të thellë profesional dhe shkencor në fushën e ekonomisë dhe teknologjisë.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.53 Dosja e programit - BSC-IE-Te dhena te pergjithshme.pdf</p> <p>Aneksi Nr.56 Plan programet syllabuset e programit Bch Informatike Ekonomike.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Mbështetur tek informacioni i marrë në takimin me përgjegjës të departamentit dhe pedagogët, GVJ u informua që syllabuset e lëndëve diskutohen në mbledhje të departamentit çdo vit, me qëllim përmirësimin e tyre në aspektin e përmbajtjes dhe të metodologjisë, dhe për të sjellë zhvillimet e fundit në fushën përkatëse. Të gjitha ndryshimet e propozuara dërgohen në dekanat për miratim.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Në bazë të aktiviteteve të përcaktuara në programin e lëndës, kompetencat dhe aftësitë që ka fituar studenti testohen nëpërmjet projekteve të kursit, ose testeve me shkrim të cilat përmbajnë edhe pyetje analitike apo raste studimi.</p> <p>Në përfundim të çdo lënde pedagogu bën përmbledhje e të gjithë çështjeve kryesore dhe orienton studentët për tu përgatitur për provimin përfundimtar. Gjithashtu gjatë sezonit të provimeve studentët kanë mundësi të konsultohen me pedagogët e tyre për paqartësitë që mund të kenë.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.56 Plan programet syllabuset e programit Bch Informatike Ekonomike.pdf</p> <p>Aneksi Nr.63 FE Proçedura për zhvillimin e provimeve FE.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Nga takimi me pedagogët dhe studentët, GVJ u informua që UMT organizon gjithmonë leksione të hapura me specialistë të mirënjohur të fushës së teknologjisë së informacionit apo ekonomisë, apo lektorë vendas dhe të huaj për të sjellë të reja të shkencës apo teknologjisë në shërbim të pasurimit të njohurive që marrin studentët në këtë program studimit. Këtë gjë GVJ e evidenton edhe nga prezantimi i këtyre aktiviteteve në faqen e web-it të UMT.</p> <p>Evidenca:</p> <p>https://umt.edu.al/evente-sq</p> <p>Aneksi Nr.99 Lektorë të huaj të ftuar në UMT nga Fakulteti i Ekonomisë.pdf</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në</p>	<p>Bazuar tek natyra e programit që është shumë pranë inovacionit, si dhe tek programet e lëndëve, plani mësimor, apo edhe eksperiencat e stafit akademik të këtij programi studimi, mund të themi që mësimdhënia realizohet mbi bazën e aplikimit në laborator, të njohurive të marra në</p>

laboratorë dhe praktikat profesionale.	leksione dhe seminare. Mësimi i përshtatet natyrës së lëndës dhe ofron zhvillim kompetencash nëpërmjet projekteve të studentëve.			
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Në takimin me pedagogët GVJ u informua që personeli akademik inkurajon studentët të përfshihen në aktivitete dhe detyra grupi që lidhen me situata hipotetike të biznesit dhe organizatave dhe të diskutojnë për zgjidhjet e tyre. Stafi akademik mundohet të ofrojë një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, duke i mbështetur ata në pjesmarrjen në studime të avancuara kërkimore konferenca, konkurse apo aktivitetet të tjera.			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Gjithashtu rritja e marrëveshjeve të bashkëpunimit ka mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. Evidenca: Aneksi Nr.56 Plan programet syllabuset e programit Bch Informatike Ekonomike.pdf Aneksi Nr.61 CV te personelit.pdf Aneksi Nr.28 Lista e Shkembimeve nderkombetare UMT.pdf			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.				
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Në bazë të dokumentave të shqyrtuara (Rregullore e UMT Neni 54) “ <i>në fund të ciklit të parë të studimit, studentët i nënshtrohen një provimi formimi për mbrojtjen e diplomës</i> ”. Modalitetet dhe procedurat për zhvillimin e provimit të formimit përcaktohen në Rregulloren e UMT. Përgjegjësi i Departamentit na informoi se këto procedura bëhen të njohura për studentët. Organizimi përcaktohet në Rregulloren e UMT Neni 58. UMT organizon provimin e formimit në tre sezona, verë, vjeshtë dhe dimër të cilat shpallen nga rektori dhe datat caktohen nga dekani. Provimi i formimit është gjithpërfshirës, dhe mbulon tema të fushave kryesore të programit të studimit të zhvilluara gjatë tre viteve. Departamenti
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	

<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>organizon konsultime me studentët për përgatitjen për këtë provim, datat shpallen sipas një grafiku të miratuar nga dekanati.</p> <p>Komisioni i posaçëm i provimit është i përbërë nga pedagogë efektivë dhe të jashtëm që mbulojnë programin e studimit. Teza e provimit përmban pyetje të të gjitha fushave që përfshin programi, pesha specifike që kanë pyetjet e çdo fushe caktohet nga dekanati. Departamenti harton fondin e pyetjeve që e dorëzon atë në dekanat dy javë para fillimit të sezonit të provimit final.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Sipas RVB kriteri 3, “<i>në këtë vit akademik është parashikuar që për kryerjen e detyrimeve finale është parashikuar punim për studentët me mesatare mbi 8 dhe provim për pjesën tjetër të studentëve</i>”. GVJ konstaton se referenca (Aneks Nr. 63, Udhëzim për zhvillimin e provimeve_FE) që RVJ jep për këtë vendim nuk përmban ndonjë informacion të tillë.</p> <p>Pas hartimit të Draft RVJ nga GVJ, institucioni dorëzoi dhe u ngarkua në sistemin AMS të ASCAL, dokumenti “Vendim: Mbi disa rregulla lidhur me udhëheqjen dhe mbrojtjen e tezave të diplomave“ datë 07.04.2021, të cilin GVJ e merr në konsideratë dhe bëri ndryshimet përkatëse në këtë kriter në përputhje me këtë dokument. Në këtë dokument gjenden modelitetet e procesit të diplomimit të studentëve me temë diplome, që nga caktimi i udhëheqësit, konsultimet, kontrolli anti-plagjaturë e deri tek faza e mbrojtjes së punimit.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</p> <p>Vendim: Mbi disa rregulla lidhur me udhëheqjen dhe mbrojtjen e tezave të diplomave“ datë 07.04.2021</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Për studentët e programit të studimit bachelor këto nuk janë të aplikueshme, meqenëse në bazë të Rregullores ata e mbrojnë diplomën me provim formimi.</p> <p>Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Sipas rregullores së UMT, rezultatet e provimit të formimit u shpallen studentëve brenda tre ditëve, nga komisioni i provimit, pas të gjitha</p>

Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	<p>procedurave të cilat janë të parashikura në këtë rregullore notat hidhen në fletën e provimit e cila firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit.</p> <p>Nëse studenti ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur diplomën (me temë ose provim formimi) pajiset me diplomë të shoqëruar me suplementin përkatës (Neni 59 Rregullore e UMT). Në përfundim të studimeve studentit i vihet gjithashtu në dispozicion edhe një kopje zyrtare e plotë e programit të studimit.</p> <p>Nga informacioni i marrë në Sekretarinë Mësimore, GVJ u informua që institucioni ruan kopje të dokumentacionit të studentit sipas legjislacionit në fuqi. Sipas Rregullores së institucionit dhe sekretarisë informacionet për studentin mund të vihen në dispozicion të të interesuarve duke procesur sipas rastit.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</p> <p>Aneksi Nr.95 FE Rregullore e Sekretarisë.pdf</p> <p>Aneksi Nr.60 Suplement Diplome Bsc Informatike ekonomike.pdf</p>			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.				
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Duke u mbështetur tek dokumentacioni i vënë në dispozicion (Rregullore e UMT; Organigrama e UMT) si dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për mbedhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të UMT. Këto të dhëna përfshijnë personelin akademik efektiv, atë me kontratë dhe atë administrativ. Të dhënat mblidhen dhe administrohen në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, në takim me përfaqësues të zyrës së Burimeve Njerëzore, GVJ konstatoi që kjo zyrë i mban të dhënat e personelit në dosje personale në format të printuar. GVJ u njoh me disa nga dosjet e protokolluara që u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme. Këto dosje përmbanin dokumentat e plota të personelit, të tilla si: CV, dokumentin e identifikimit, pozicionin e punës, diplomat dhe listat e notave, gradat shkencore, dëshmitë e gjuhëve të huaja, dëshmitë e trajnimeve dhe kualifikimeve, kontratën e punës, etj.</p> <p>Gjithashtu GVJ konstaton se informacioni për angazhimin e personelit në çdo semestër dhe vit akademik mbahet nga Departamenti i Informatikës Ekonomike përgjegjës për këtë program studimi.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.04 UMT Organigrama.pdf Aneksi Nr.57 Ngarkesa në auditor sipas formës së mësimdhënies-Tabela nr. 4 dhe tabela 13.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se UMT i harton procedurat e rekrutimit të personelit akademik në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 dhe mbështetur në dokumentat e brendshme të institucionit: Statuti i UMT, Pjesa e Tretë; Rregullorja e UMT, Neni 11, 12; Udhëzim mbi Politikat dhe Procedurat e Rekrutimit të Stafit Akademik. Në këto dokumenta janë përcaktuar: kërkesat e përgjithëshme dhe specifike për të qenë punonjës i UMT, procedurat e përzgjedhjes së kandidatit, shpallja dhe procesi i konkurimit, mënyra e vlerësimit, etj. Procedurat për shpalljen e vendeve vakante dhe rekrutimin e personelit ndiqen nga Zyra e Burimeve Njerëzore që është nën varësinë e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, e cila i bën ato publike.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh me këto procedura nëpërmjet përfaqësuesit të zyrës së Burimeve Njerëzore si dhe në takim me personelin</p>

	<p>dhe drejtuesit e institucionit, dhe konstatoi se këto procedura janë të hapura dhe transparente.</p> <p>GVJ konstaton që kërkesat për personel akademik vijnë nga njësia bazë, bazuar tek planet mësimore dhe ngarkesa mësimore, miratohen nga njësia kryesore dhe aprovohen nga Rektori. Kriteret specifike për personelin akademik për këtë program studimi përcaktohen nga Departamenti i Informatikës Ekonomike me miratim të Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë. Më pas ato përcillen në Rektorat për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të rekrutimit. Këto kritere kanë bazë kualifikimet akademike dhe eksperiencën e punës në përputhje me kërkesat e pozicionit vakant dhe fushën specifike sipas lëndëve të programit të studimit. Punësimi realizohet me procedurë të konkurimit të hapur publik, në një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv.</p> <p>Njoftimet për vendet vakante gjenden edhe në faqen e web-it të institucionit: https://umt.edu.al/puno-ne-umt. Këto njoftime përmbajnë kërkesat e përgjithëshme dhe specifike, përkatëse sipas vendeve vakante të shpallura.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.01 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.31 Rregullore rekrutimi.pdf https://umt.edu.al/puno-ne-umt</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>UMT i zhvillon procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të kandidatëve për personel në përputhje me Udhëzimin mbi Politikat dhe Procedurat e Rekrutimit të Stafit Akademik, si dhe përcaktimet në Rregulloren e UMT dhe Statutin e UMT. Udhëzimi përcakton procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve, mënyrën e shpalljes dhe realizimit të konkursit dhe mënyrën e vlerësimit. Për të gjitha kategoritë e rekrutimit të stafit ngrihen komisione ad hoc, rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të të cilit caktohen në aktet e brendëshme të UMT (Statuti i UMT). Këto komisione kanë kryesisht 5 anëtarë, nga të cilët 1 përfaqësues i Dekanatit, 1 përfaqësues i Rektoratit dhe 3 përfaqësues nga njësia bazë me të cilën lidhet kërkesa për vendin vakant. Në përgjithësi procesi i rekrutimit kalon në këto faza: publikohen vendet vakante në faqen e web-it të UMT me kriteret e përgjithëshme dhe specifike, bëhet përzgjedhja e kandidaturave që plotësojnë kriteret dhe intervistohen kandidatët nga komisioni ad hoc i ngritur specifikisht në përputhje me vendin vakant.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me disa dosje të procedurave të rekrutimit të personelit pranë zyrës së Burimeve Njerëzore, dhe konstatoi se këto procedura janë ndjekur për të gjithë stafin e rekrutuar.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.01 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.31 Rregullore rekrutimi.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>GVJ vizitoi dhe u njoh me mjediset dhe kushtet e punës për personelin akademik dhe administrativ në UMT. Godinat ku zhvillohen aktivitetet mësimore të këtij programi studimi kanë një infrastrukturë të përshtatshme dhe funksionale, në përputhje me kriteret teknike dhe standardet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Godinat ofrojnë kushte shumë të mira pune dhe të përshtatshme për kryerjen e detyrave profesionale të personelit të UMT. Të gjitha mjediset që lidhen me procesin mësimor janë të pajisura me mjete të teknologjisë së informacionit (kompjuterat, printera, skanera, etj.) si dhe mbulohen nga rrjeti wireless që ofron Internet për stafin dhe studentët.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.107 Ambjentet për Infrastrukturën e programit Bsc ne IE.pdf Aneksi Nr.108 Mjediset dhe Asete infrastrukturore akademike - UMT-Tab-Nr.16.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Gjatë takimit në institucion me personelin akademik përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, GVJ u informua se UMT ofron angazhimin e tij për ti dhënë mundësi pedagogëve të kenë një kualifikim dhe zhvillim profesional të vazhdueshëm. Institucioni mbështet pjesëmarrjen e personelit në projektet kërkimore dhe mobilitetet e mundësuar prej ERASMUS+, si një mënyrë efektive për njohjen dhe përmirësimin e aftësive kërkimore dhe metodave të mësimdhënies. Gjithashtu UMT i ofron personelit mundësinë e trajnimeve të ndryshme nëpërmjet projektit Bolonja. GVJ konstaton gjithashtu se UMT mbështet financiarisht personelin akademik për pjesëmarrje në konferenca si dhe botime të artikujve në revista shkencore.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.03 Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf Aneksi Nr.73 Raport Vjetor FE PER MINISTRINE 2019-2020.pdf Aneksi Nr.25 Marredheniet me jashte dhe projektet, Mobiliteti Akademik.pdf Aneksi Nr.28 Lista e Shkembimeve nderkombetare UMT.pdf Aneksi Nr.32 Kurse trajnimi per teknikat e mesimdhënies flipping classroom dhe Projekti Bolonja.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Në takimin me personelin akademik, përgjegjës in e Departamentit të Informatikës Ekonomike dhe Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, GVJ u informua që institucioni nxit dhe mbështet zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies si dhe përdorimin e teknologjive të reja. Kjo mbështetje konsiston jo vetëm në ofrimin e mundësi për mobilitete dhe pjesëmarrje në projekte kërkimore shkencore me partnerë të huaj të stafit akademik, por edhe në ofrimin e trajnimeve në lidhje me përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie. Në bazë të dokumentave</p>

	<p>të shqyrtuara (Metodat inovative të mësimdhënies që përmirësojnë angazhimin e studentëve; Manuali i platformës së mësimi online) GVJ konstaton se trajnimet e stafit kanë konsistuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trajnime për implementimin e sistemit elektronik për përdorimin e platformës së menaxhimit të programit të studimit edu4schools. - Trajnime për shkrimin dhe aplikimin në projekte të kërkimit shkencor nga AKKSHI. - Leksione të hapura nga lektorë të huaj. - Etj. <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.102 FE Raporti për metodat inovative në procesin e mësimdhënies.pdf Aneksi Nr.44 UMT Manual përdorimi të sistemit informatik të studentve.pdf Aneksi Nr.48 UMT Platforma për mësimin online.pdf Aneksi Nr.49 Udhëzimi mbi mësimdhënien në distancë.pdf Aneksi Nr.72 Lista e vizitave të stafit akademik të huaj në UMT.pdf</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion (Fakulteti i Ekonomisë Tabelat Përmbledhëse), si dhe në informacionet e marra gjatë vizitës, GVJ konstaton se Fakulteti i Ekonomisë si dhe Departamenti i Informatikës Ekonomike, përgjegjës për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, dëshmojnë një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të këtij programi studimi, duke përmbushur edhe kërkesat ligjore për numrin (VKM 418, Maj 2017) dhe nivelin e kualifikimit të stafit (Tabela 7 Stafit sipas kualifikimit).</p> <p>Gjatë vitit 2020 – 2021 për realizimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike janë angazhuar 15 pedagogë si personel akademik efektiv (PAE) dhe 7 pedagogë me kontratë (PAK), si dhe 1 personel ndihmës akademik. Titujt dhe gradat e personelit akademik janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3 pedagogë me titullin Prof. Dr. - 2 pedagogë me titullin Prof. Asoc. Dr. - 9 me titullin Dr. - 8 pedagogë me Master Shkencor (nga të cilët 4 në proces Doktorature) <p>Në bazë të dokumentave të dorëzuara (Tabela 12.1 Të dhëna për mbulimin e lëndëve me personel akademik) personeli akademik efektiv mbulon 84% të programit Bachelor në Informatikë Ekonomike dhe personeli akademik me kontratë 16% të tij.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Tabelat Përmbledhëse.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ vizitoi mjediset e UMT dhe konstatoi, bazuar edhe tek dokumentacioni mbështetës (Infrastruktura për Fakultetin e Ekonomisë), se institucioni e zhvillon veprimtarinë mësimore në dy godina: Godina 1 me sipërfaqe 2347 m² dhe Godina 2 me sipërfaqe 2490 m², që ofrojnë një infrastrukturë moderne, komode dhe të përshtatshme për grupet mësimore të këtij programi studimi dhe numrin e studentëve në to, në përputhje me natyrën specifike të programit dhe modulet e tij, si dhe në përputhje me kriteret teknike dhe standardet e përcaktuara në VKM Nr. 418, dt. 10.05.2017. Në 2 godinat e UMT gjenden sallat e leksioneve, sallat e seminareve, 6 laboratorë informatike dhe biblioteka.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.107 Ambjentet për Infrastrukturën e programit Bsc ne IE.pdf Aneksi Nr.108 Mjediset dhe Asete infrastrukurore akademike - UMT-Tab-Nr.16.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mbështetur tek vizita në mjediset e UMT dhe dokumentacioni i shqyrtuar (Infrastruktura e programit Bsc në IE), GVJ konstaton se klasat janë të pajisura me videoprojektorë, sisteme audio, lidhje interneti wireless falas për studentë dhe stafin që garantojnë më së miri realizimin e procesit mësimor teorik e praktik. Studentët dhe stafi kanë akses të plotë në sisteme që mundësojnë përdorimin e teknologjisë bashkëkohore, dhe i shërbejnë realizimit të programit të studimit. Në funksion të zhvillimit sa më mirë të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, UMT ka pajisur me lap top të gjithë studentët e këtij programi. Një nismë shumë e mirë që vlen për tu lavdëruar është edhe pajisja me lap top e të gjithë studentëve të të gjitha programeve të studimit gjatë vitit 2020 – 2021 në ndihmë të realizimit të mësimin online. GVJ u informua që institucioni e ka kthyer këtë në një standard për vitet në vazhdim.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Sikurse është përmendur edhe më lart, institucioni disponon 6 laboratorë informatike, 2 nga të cilët janë në funksion të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, të pajisur me PC për çdo student. Gjithashtu në shërbim të studentëve është edhe një sallë interneti. Në përputhje me programin mësimor shumica e lëndëve të këtij programi studimi zhvillohen në laborator ku studentët përdorin programe specifike profesionale sipas lëndëve që zhvillojnë (dokumenti: Plan programet e lëndëve/syllabusët: Programi Informatikë Ekonomike). Përveç programeve që lidhen me fushën e Informatikës, studentët përdorin në laborator edhe programe që lidhen me lëndë të tjera të tilla si ato të Financës, Kontabilitetit, Menaxhimit e Burimeve Njerzore, etj.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	

	<p>Për sa u tha më sipër, GVJ konkludon se mjediset mësimore (klasat, labororet, etj) të UMT janë në mbështetje të realizimit të objektivave formues të këtij programi studimi.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.107 Ambjentet për Infrastrukturën e programit Bsc ne IE.pdf Aneksi Nr.108 Mjediset dhe Asete infrastrukturore akademike - UMT-Tab-Nr.16.pdf Aneksi Nr.56 Plan programet syllabuset e programit Beh Informatike Ekonomike.pdf Aneksi Nr.44 UMT Manual përdorimi të sistemit informatik të studentve.pdf</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit (Lista e marrveshjeve në kuadër të programeve të FE) si dhe nga informacioni që GVJ mori në takimin me Përgjegjësin e Departamentit të Informatikës Ekonomikës si dhe Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, konstatohet që UMT ka nënshkruar 63 marrëveshje bashkëpunimi me institucione të huaja, si dhe kompani dhe institucione të sektorit publik dhe privat, të cilat mundësojnë zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve të këtij programi studimi.</p> <p>Sipas planit mësimor të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, praktika profesionale/mësimore është 150 orë, nga të cilat 120 orë studenti i realizon pranë institucioneve me të cilat UMT ka marrëveshje dhe 30 orë janë punë e pavarur e studentit në klasë apo në auditorët e UMT. Në takimin me studentët GVJ u informua që ata i zhvillojnë këto orë në laborator, për zhvillimin e programeve kompjuterike që i përkasin fushës së tyre të studimit.</p> <p>Nga sa u tha më sipër GVJ konstaton se institucioni i ofron studentëve të gjitha mundësitë për të realizuar praktika profesionale në përputhje me standardet.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.22 UMT Lista e marrëveshjeve në kuadër të programeve të FE.pdf Aneksi Nr.23 Lista e marreveshjeve ne kuader te programeve te fe.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e</p>	<p>GVJ vizitoi Bibliotekën e UMT, të vënë në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik, në mbështetje të procesit mësimor dhe formimit të tyre profesional. Biblioteka ndodhet në katin e parë të Godinës 1 dhe ofron mundësi aksesit për të gjithë studentët dhe stafin. Të gjithë studentët kanë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 47

<p>shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>mundësi të barabarta në përdorimin e saj, paradite ose mbasdite, dhe materialet e bibliotekës mund të përdoren ose në mjedisin e bibliotekës, ose mund të huazohen për përdorim të jashtëm në bazë të kërkesave apo prenotimeve të studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion (Inventari i Bibliotekës së UMT) GVJ konstaton se biblioteka disponon në fondin e saj rreth 758 libra, si dhe një numër të konsiderueshëm revistash, cikël leksionesh dhe materiale të tjera në ndihmë të studentëve. <i>Megjithatë GVJ mendon se pavarësisht se institucioni ka bërë përpjekje të konsiderueshme për shtimin e literaturës në bibliotekë, në përmbushje të rekomandimeve të lëna në akreditimin e parë të këtij programi studimi, përsëri ka vend për shtimin e titujve të librave në literaturën fizike apo online, sidomos në gjuhën shqipe, për të mbështetur nevojat e programit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Gjithashtu është e nevojshme që të përditësohet literatura me botime të pesë viteve të fundit.</i></p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.109 Biblioteka UMT inventari.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në mjediset e bibliotekës, si dhe mbështetur tek dokumentacioni i shqyrtuar (Të dhëna të plota për platformat online) <i>GVJ konstaton se ka një numër të kufizuar mundësish, përsa i përket numrit të tyre, për të aksesuar bibliotekat online.</i> Institucioni ofron sistemin “edu4school” i cili ju jep akses të pakufizuar studentëve në materialet mësimore që ofrohen nga pedagogët në përputhje me literaturën e sugjeruar në syllabus-e. GVJ u informua nga punonjësit e bibliotekës që institucioni ka zgjedhur të bëjë abonimin në bibliotekat online sipas kërkesave të departamenteve, në mënyrë që dhe shërbimi të jetë në përputhje me nevojat dhe fushën e tyre të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Gjithashtu biblioteka ofron kompjutera me programe kompjuterike që ju jep studentëve mundësinë e shfrytëzimit pa kufizime, megjithatë <i>GVJ konstaton se numri i tyre është i vogël dhe sugjeron shtimin e kompjuterave në bibliotekë për ti shërbyer sa më mirë navigimit të studentëve në burimet online të literaturës.</i></p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.109 Biblioteka UMT inventari.pdf Tabelat Permbledhese.pdf – Tabela 17</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Në bazë të RVB dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua që UMT parashikon fonde çdo vit për shtimin e literaturës në bibliotekë. <i>Megjithatë në buxhetin e vitit 2020 – 2021 nuk ka një ndarje të qartë të fondit të alokuar për pasurimin e bibliotekës. Gjithashtu GVJ nuk konstaton ndonjë dokument që të paraqesë planin e detajuar të shtimit të zërave të bibliotekës, në bazë të kërkesave të njëjësive bazë apo kryesore. GVJ sugjeron hartimin e një plani të detajuar vjetor për shtimin e literaturës që lidhet me këtë program studimi, apo përditësimin e literaturës ekzistuese me botime të 5 viteve të fundit.</i></p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.128 Buxhet 20-21.pdf</p>

<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Bazuar tek informacioni i marrë gjatë vizitës në bibliotekën e UMT, GVJ konstaton që ajo qëndron e hapur në dispozicion të studentëve nga ora 10.00 paradite deri në orën 21.00 të mbrëmjes. GVJ gjykon që orari është i përshtatshëm për tu shfrytëzuar nga studentët e interesuar duke qenë në një fashë e gjërë orari, pa ju cënuar oraret e zhvillimit të procesit mësimor. <i>Përsa i përket hapësirave fizike që ofron biblioteka, GVJ sugjeron shtimin e këtyre hapësirave për ti dhënë mundësi një numri më të madh studentësh të aksesojnë burimet e saj në të njëjtën kohë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore GVJ u informua se informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre që nga regjistrimi deri në diplomim administrohet nga kjo zyrë (bazuar edhe tek dokumentacioni: Rregullore e UMT, Rregullore e Sekretarisë). Që nga viti akademik 2019 – 2020 UMT disponon sistemin elektronik të menaxhimit të informacionit “edu4school” ndërsa vitet më parë ka përdorur sistemin e informacionit të sekretarisë online (SIS) dhe Portalin e Studentit. Sekretaria administrohet gjithë informacionin që lidhet me studentët, të dhënat personale të tyre, notat, etj, në formën e regjistrave fizikë dhe nëpërmjet sistemit elektronik. GVJ u njoh me regjistrat gjatë vizitës në institucion dhe dosjet personale të studentëve. GVJ zgjodhi në mënyrë të rastësishme disa emra të studentëve të këtij programi studimi dhe konstatoi që të gjithë të dhënat e tyre në dosje, notat në regjistër dhe procesverbale, numrat e matrikullimit, etj, ishin pasqyruar korrekt.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.95 FE Rregullore e Sekretarisë.pdf Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Bazuar tek dokumentacioni i shqyrtuar, ashtu sikurse e kemi përmendur edhe në Standardin IV.1, zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të UMT. Kjo zyrë i mban të dhënat e personelit në dosje personale në format të printuar. Dosjet e personelit përditësohen periodikisht dhe në to gjenden këto dokumenta:</p> <ul style="list-style-type: none"> - CV e personelit (për personelin akademik, CV shoqërohet me fotokopje të artikujve dhe botimeve shkencore); - Fotokopje e pasaportës / ID dhe adresa e banimit; - Formular vetëdeklarimi / dëshmi penaliteti; - Pozicioni i punës; - Diplomati;

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 49

	<ul style="list-style-type: none"> - Gradat shkencore / titujt akademikë; - Libreza shëndetsore; - Kualifikime të tjera / informacione shtesë. <p>Evidenca: Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.04 UMT Organigrama.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Ashtu sikurse e kemi përmendur në Kriterin 1 të këtij standardi, UMT përdor sistemin elektronik të menaxhimit të informacionit “edu4school”. Nëpërmjet këtij sistemi sigurohet akses i dedikuar për të gjithë personelin dhe studentët si dhe përgjegjësit e organeve të tjera drejtuese të UMT. Në bazë të Rregullores së UMT, përcaktohet organizimi dhe funksionimi i njësisive ndihmëse dhe administrative të saj, sikurse dhe informacioni që ato administrojnë. Nëpërmjet sistemit “edu4school” stafi akademik ju jep akses studentëve në dokumenta të tilla si: syllabuset e lëndëve, materialet mësimore, informacion mbi frekuentimin, vlerësimet e vazhduara, notat, kreditet etj.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nëpërmjet këtij sistemi i cili përmban platforma të integruara realizohet komunikimi midis palëve sipas kompetencave që e përcakton Rregullorja e UMT. Shkëmbehet informacioni midis pedagogëve dhe sekretarisë për rezultatet e studentëve apo frekuentimin e tyre, shkëmbehet informacion midis studentëve dhe sekretarisë për notat, kreditet, etj, si dhe informacion midis pedagogëve dhe studentëve për të gjithë materialin që lidhet me procesin mësimor.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Gjithashtu komunikimi në UMT realizohet nëpërmjet postës elektronike me adresat e email-it të domain-it umt.edu.al.</p> <p>Një tjetër formë komunikimi janë edhe platformat e ndryshme të rrjeteve sociale dhe faqja e web-it të UMT, nëpërmjet të cilave bëhet komunikimi jo vetëm midis stafit dhe studentëve, por edhe shpërndahet informacion për palët e treta të interesuara për programet e studimit në UMT.</p> <p>Bazuar tek karakteristikat dhe funksionet e sistemit elektronik të informacionit “edu4school”, GVJ konstaton se ai mundëson jo vetëm komunikimin në kohë reale midis palëve, por edhe dokumentimin dhe raportimin e informacionit sipas nevojave të organeve drejtuese të UMT.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.44 UMT Manual përdorimi të sistemit informatik të studentëve.pdf Aneksi Nr.43 UMT Sistemi informatik i menaxhimit të studentëve.pdf https://umt.edu.al/ Aneksi Nr.36 Faqa Web dhe rrjetet sociale.pdf Aneksi Nr.95 FE Rregullore e Sekretarisë.pdf Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e</p>	<p>Informacionet që lidhen me programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, personelin akademik të përfshirë në të, aktivitetet e ndryshme të Departamentit të Informatikës Ekonomike apo Fakultetit të Ekonomisë përgjegjës për këtë program studimi, si dhe informacione të tjera që lidhen</p>



internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	me UMT, gjenden të qarta dhe të detajuara në faqen e web-it https://umt.edu.al . Informacionet janë në dy gjuhë: në shqip dhe në anglisht. Përveç faqes së web-it, UMT i publikon informacionet e veta të cilat i ndan me publikun edhe në kanale të tjera të informimit dhe media sociale. Evidenca: https://umt.edu.al/ Aneksi Nr.36 Faqa Web dhe rrjetet sociale.pdf Aneksi Nr.95 FE Rregullore e Sekretarisë.pdf		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar (Statuti i UMT) GVJ konstaton se UMT harton dhe miraton buxhetin në përputhje me Statutin, Seksioni VIII, Neni 31. Miratimi i buxhetit bëhet nga Bordi i Administrimit nën drejtimin e Kryetarit të Bordit. Përgatitja e buxhetit bëhet nga administratori në përputhje me parashikime ligjore, Statutin dhe Rregulloren e UMT. Njësitë bazë të UMT paraqesin kërkesat e tyre për vitin e ri akademik, pas miratimit në nivelet përkatëse këto kërkesa përcillen në departamentin e financës i cili bën unifikimin e tyre brenda buxhetit të institucionit si një njësi e vetme.
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar (Shpenzime dhe të ardhura tre vitet e fundit) GVJ konstaton se institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimit që ai ofron në nivel institucional. Në bazë të RVB kostot e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike mbulohen nga të ardhurat e siguruar nga tarifat e studimit të studentëve. Plani i financimit të programeve të studimit përmban të gjitha zërat që përcakton standardi të tilla si financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative, shpenzime për kërkim & zhvillim, etj. Konstatohet në këtë plan që shpërndarja e detajuar e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në nivel institucional dhe sipas njësisive kryesore, janë bërë duke u mbështetur tek kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë nr. 80/2015. Evidenca: Aneksi Nr.01 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.128 Buxhet 20-21.pdf Tabelat Permbledhese.pdf-tabela 18
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson	Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar GVJ konstaton se institucioni kryen auditimin e përvitshëm me auditues ligjor të pavarur. Në dokumentin

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 51,

dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	<p>“Raporti Auditues Pasqyrat Financiare të Vitit 2020” paraqiten në mënyrë të hollësishme analiza në lidhje me të ardhurat dhe kostot për studentë duke argumentuar edhe përputhjen e performancës financiare të UMT në lidhje me standardet kontabël të miratuara.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.129 Raporti Auditues Pasqyrat Financiare Viti 2020.pdf</p>			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se UMT dokumenton raporte të përvitshme financiare në nivel institucional, dhe jo të detajuara për programet specifike të studimit që ofron. Në bazë rezultateve të raportit të një viti, parashikohen ndërhyrje në buxhetin që miratohet nga bordi i administrimit për vitin pasardhës, duke plotësuar nevojat apo kërkesat që vijnë nga njësitë bazë apo njësitë kryesore.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.128 Buxhet 20-21.pdf Aneksi Nr.129 Raporti Auditues Pasqyrat Financiare Viti 2020.pdf Tabelat Permbledhese.pdf-tabela 18</p>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	<p>Bazuar tek pasqyrat e raportit financiar si dhe raporti i auditit ligjor të jashtëm GVJ konstaton se UMT dëshmon se garanton qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të këtij program studimi por edhe të programeve të tjera të studimit që ky institucion ofron. Bazuar tek dokumentat (Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në UMT në 4 vitet e fundit) të ardhurat gjatë 4 viteve të fundit kanë ardhur kryesisht nga “Grantet për kërkim dhe kontratat” si dhe nga “Tarifat për dhe gjatë shkollimit”. Bazuar tek tabelat e buxhetit për 2 vitet e fundit konstatohet se të ardhurat janë në rritje, që gjë mbështet qëndrueshmërinë financiare të institucionit.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.128 Buxhet 20-21.pdf Aneksi Nr.129 Raporti Auditues Pasqyrat Financiare Viti 2020.pdf Tabelat Permbledhese.pdf-tabela 18</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ konstaton se UMT ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Këto procedura janë të përcaktuara në dokumentat: Procedura për aplikimin dhe regjistrimin e studentëve në ciklet e studimit në Fakultetin e Ekonomisë; Rregullore e UMT Kreu III; VI; Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë Kreu III; Statuti i UMT Kreu V Neni 68-72. Këto politika dhe procedura janë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi përkatësisht me Ligjin Nr. 80/2015, dhe udhëzimin e MASR, Nr. 10, datë 15.05.2019 si edhe Udhëzimin e MASR, Nr. 17, datë 30.07.2019 për pranimin e studentëve në programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Kriteret e pranimit dhe informacionet e tjera për procedurat e regjistrimit që duhet të ndjekin kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në këtë program studimi janë të publikuara edhe në faqen e web-it të UMT. GVJ konstaton se të gjitha procedurat garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Kjo gjë është e përcaktuar edhe në Rregulloren e UMT Neni 15, 16 dhe në Statutin e UMT Neni 68, që përcaktojnë të drejta dhe detyrime të barabarta për të gjithë studentët e regjistruar në çdo program studimi të ofruar nga UMT.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Gjithshtu GVJ konstaton që kriteret dhe procedurat e sipërpërmendura janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme për cilindo që është i interesuar nëpërmjet faqes së web-it të UMT si dhe kanaleve të tjera formale të komunikimit. Evidenca: Aneksi Nr.01 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.30 UMT Procedura e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT.pdf https://umt.edu.al/pranimet-ne-programet-bachelor
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Kriteret për pranimin e studentëve në ciklet e studimit Bachelor në UMT propozohen nga njësi kryesore dhe më pas miratohen me vendim të Senatit Akademik të UMT. Më pas këto vendime i dërgohen Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Në bazë të dokumentacionit (Statuti Neni 68; Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë Neni 20; Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Informatikë Ekonomike Kreu IV) GVJ konstaton se kriteri bazë i pranimit është diploma e shkollës së mesme dhe mesatarja e shkollës së mesme që përcaktohet çdo vit nga MASR. Gjithashtu në këto dokumenta përcaktohet që institucioni miraton edhe kriteret shtesë për pranimin në ciklin
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në	

<p>përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>e parë të studimeve dhe ja dërgon ato ministrisë. GVJ nuk konstaton kriteret specifike për këtë program studimi.</p> <p>Të gjitha informacionet në lidhje me kriteret publikohen në fillim të çdo viti akademik në faqen e web-it si dhe nga sektori i marketingut të UMT. Përpara fillimit të çdo viti akademik gjithashtu institucioni realizon takime informuese me të interesuarit ku ofrohen edhe informacionet nëpërmjet broshurave dhe mjeteve të tjera, në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike.</p> <p>Gjithashtu në bazë të dokumentave të sipërpërmendura si dhe Vendimit të Senatit për miratimin e kuotave të pranimeve për vitin akademik 2021-2022, institucioni parashikon edhe kuota për studentët e huaj dhe kategori të caktuara në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ata ndjekin të njëjtën procedurë pranimi dhe regjistrimi të parashikuara në Rregulloren e UMT.</p>			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzohet publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.01 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.50 FE Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf Aneksi Nr.58 Rregullore programi informatika ekonomike.pdf Aneksi Nr.34 Kuotat e pranimit 2021 – 2022.pdf Aneksi Nr.30 UMT Procedura e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT.pdf https://umt.edu.al/pranimet-ne-programet-bachelor https://umt.edu.al/image.ashx?i=1376486.pdf&fn=Broshura%20UMT.pdf Aneksi Nr.78 Broshura UMT guida.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, si dhe në takimin me studentët dhe pedagogët, GVJ konstaton që UMT informon në mënyrë të plotë dhe të hollësishme studentët që në vitin e parë të studimeve të tyre në lidhje me procedurat e përparimit akademik dhe kalimin nga një vit në tjetrin. Gjatë regjistrimit të tyre studentët marrim informacione të rëndësishme në lidhje me procesin mësimor, oraret, detyrimet akademike, provimet, etj, nëpërmjet sekretarisë mësimore. Në fillim të çdo semestri pedagogët ju prezantojnë studentëve syllabueset e lëndëve, procedurat për përparimin akademik, detyrimet e lëndës, mënyrën e vlerësimit, kërkesat për frekuentimin, etj.</p> <p>Gjithshtu informacionet në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit në tjetrin janë të përshkuara</p>

	<p>hollësisht në dokumentat: Rregulloren e UMT Kreu IV Nenet 23 -36; Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Informatikë Ekonomike Kreu III.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.58 Rregullore programi informatika ekonomike.pdf Aneksi Nr.63 FE Proçedura për zhvillimin e provimeve FE.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit (Statuti i UMT Neni 72, Rregullore e UMT Kreu VI, Rregullore e FE Neni 22, Procedura e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT) si dhe nga takimi me studentët, GVJ konstaton se studentëve ju vihet në dispozicion informacion i plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesëshme. Në rast transferimi këto procedura përfshijnë vlerësimin e dosjes së studentit nga një komision që shqyrton dosjen dhe e vlerëson atë për të ekuivalentuar kreditet në përputhje me udhëzimet ligjore dhe Rregulloren e UMT.</p> <p>Studentët mund të marrin informacionet për transferimin edhe nëpërmjet faqes së web-it të UMT.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.01 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.50 FE Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf Aneksi Nr.30 UMT Procedura e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT.pdf https://umt.edu.al/transferimet-e-studimeve</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se vlerësimi i dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike bëhet në bazë të rregullave të përcaktuara qartë në disa dokumenta të rëndësishme të institucionit, përkatësisht në: Rregulloren për Procedurat e Zhvillimit të Provimeve; Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike Kreu III; Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë Neni 25 - 29; Rregullore e UMT Kreu V. Të gjithë këto dokumenta janë të aksesueshëm për studentët e UMT.</p> <p>Përveç informimit nëpërmjet rregulloreve, studentët informohen në fillim të çdo semestri në çdo lëndë, për procedurat e vlerësimit të dijeve nga pedagogët e tyre, gjatë prezantimit të lëndës dhe syllabusit përkatës. Gjithashtu Sekretaria Mësimore informon studentët në çdo rast që ata kanë nevojë.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.50 FE Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf Aneksi Nr.58 Rregullore programi informatika ekonomike.pdf Aneksi Nr.63 FE Proçedura për zhvillimin e provimeve FE.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës</p>	<p>GVJ kostaton se kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në UMT përcaktohen në Rregulloren e UMT Kreu VII si dhe në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike</p>




dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>Neni 15. Në to përcaktohet që diploma në përfundim të ciklit të parë të studimeve Bachelor mbrohet me provim formimi ose temë diplome në përputhje me kurrikulat mësimore të programeve të studimit. Studentët informohen për këtë nëpërmjet pedagogëve dhe Sekretarisë Mësimore. Informimi bëhet para se të fillojë semestri i dytë i vitit të tretë dhe zgjedhja e temës së punimit bëhet para se të fillojë periudha e praktikës profesionale.</p> <p>Në takimin me studentët gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se të gjithë studentët kishin marrë informacionet e nevojshme për të gjithë procesin e diplomimit të tyre, qoftë ata me provim formimi (Rregullore e UMT Kreu VII Neni 58). qoftë ata me temë (Rregullore e UMT Kreu VII Neni 54).</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.58 Rregullore programi informatika ekonomike.pdf</p>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>GVJ konstaton se UMT në fillim të çdo viti akademik, periodikisht përpara se maturantët të përzgjedhin programet e tyre të studimit organizon takime të hapura informimi me ta, nëpërmjet zyrës së marketingut dhe shërbimit ndaj studentëve e cila bashkëpunon me njësisë bazë përgjegjëse për secilin nga programet e studimit. Takimet informuese zhvillohen jo vetëm në mjediset e UMT por edhe duke shkuar në institucionet arsimore në të gjithë Shqipërinë. Informimi i publikut bëhet jo vetëm në takimet e drejtpërdrejta informuese por edhe nëpërmjet mjeteve të tjera të tilla si fletë palosje, Guidës së UMT, rrjeteve sociale, etj. Gjithashtu studentët e ardhshëm potencialë prezantohen me programin e studimit që do të ndjekin dhe elementët kryesorë që lidhen me procesin mësimor.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.78 Broshura UMT guida.pdf https://umt.edu.al/fakulteti-i-ekonomise</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	GVJ konstaton në bazë të dokumentave të shqyrtuara (Statuti i UMT Pjesa IV; Rregullore e UMT Kreu IV; Rregullore e Programit Bachelor në Informatikë Ekonomike Neni 13; Rregullore e FE Neni 18; Dosja e programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike) se UMT ofron programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Informatikë Ekonomike me një kohëzgjatje 3 vjet dhe në në fund të diplomimit studentët pajisen me 180 kredite evropiane (ECTS) dhe u jepet diploma Bachelor në Informatikë Ekonomike. Programi zhvillohet në gjuhën shqipe. Çdo vit akademik zgjat 30 javë mësimore i ndarë në 2
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe	

<p>dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>semestra me nga 15 javë, përkatësisht me 57 kredite për vitin e parë, 60 kredite për vitin e dytë dhe 63 kredite për vitin e tretë (Plani mësimor i programit: Tabelat përmbledhëse – Tabela 10).</p> <p>Të gjitha informacionet në lidhje me strukturën e këtij programi studimi, organizimin dhe kohëzgjatjen ju vihen në dispozicion studentëve që në fillim të studimeve të tyre. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se çdo vit akademik njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit së bashku me dekanatin organizojnë takime informuese të përshtatjes së studentëve me Universitetin, Fakultetin e Ekonomisë dhe programin e studimit. GVJ u informua gjithashtu se informacione të hollësishme studentët marrin edhe në fillimit të çdo semestri nga Sekretaria Mësimore dhe pedagogët për oraret, lëndët që do të zhvillojnë, detyrimet, strukturën e semestrit, provimet, etj. Gjithashtu secili pedagog në prezantimin e lëndës shpjegon syllabusin, i cili përmban informacione rreth planit të studimit, metodës së vlerësimit, materialeve të lëndës, objektivave formuese, aftësive që fiton studenti, etj.</p> <p>Çdo informacion në lidhje me këtë program studimi përsa i përket strukturës, organizimit, kohëzgjatjes së programit, moduleve, lëndëve, përmbajtjes dhe veprimtarive formuese është lehtësisht i aksesueshëm edhe nëpërmjet portalit “edu4school” që e lidh studentin me pedagogun dhe Sekretarinë Mësimore.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.01 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.50 FE Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf Aneksi Nr.58 Rregullore programi informatika ekonomike.pdf Aneksi Nr.53 Dosja e programit - BSC-IE-Te dhena te pergjithshme.pdf Tabelat Permbledhese.pdf – Tabela 10 Aneksi Nr.56 Plan programet syllabuset e programit Bch Informatike Ekonomike.pdf https://www.edu4schools.gr/Account/Login</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit (Rregullore e Zyrës së Këshillimit të Karrierës) si dhe informacioneve që GVJ mori gjatë vizitës në institucion konstaton që UMT i jep studentëve informacione mbi mundësitë e punësimit që në prezantimin e tyre me programin e studimit që ata dëshirojnë të ndjekin, dhe më pas gjatë kohës që ata janë studentë.</p> <p>Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Shërbimit ndaj Studentëve është gjithë kohën në dispozicion të studentëve për këshillimin e karrierës, ju jep studentëve informacione rreth mundësive të ndryshme që institucioni në bashkëpunim me partnerët ofron për trajnimet, aktivitete të ndryshme, internshipe, praktika profesionale dhe mundësitë e punësimit. Gjithashtu UMT përpiqet që nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka nënshkruar të krijojë urën lidhëse midis studentëve që diplomon dhe tregut të punës.</p> <p>Përsa i përket programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në bazë të dokumentit “Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e</p>

	<p>studentëve për periudhën 2019 - 2020, Tabela 23“ konstatojmë se numri i të diplomuarve është 90%, nga të cilët 84% e tyre janë punësuar pozicione që përputhen me profilin e diplomës.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.79 Rregullore e zyrës së KARRIERES E fundit.pdf Tabelat Permbledhese.pdf – Tabela 23 https://umt.edu.al/alumni</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Sikurse është cilësuar edhe në kriteret e mësipërme të këtij standardi, çdo vit akademik njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit së bashku me dekanatin organizojnë takime informuese të përshtatjes së studentëve që regjistrohen në vit të parë për Universitetin, Fakultetin e Ekonomisë dhe programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Studentëve ju jepet një informacion i gjërë dhe i detajuar për të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me procesin mësimor, kohëzgjatjen e studimeve, lëndët, përmbajtjen e tyre, mënyrat e vlerësimit, planin mësimor, etj. Gjatë këtyre takimeve shpjegohen në detaje edhe struktura e UMT, objektivat strategjike, struktura e Fakultetit të Ekonomisë, prezantohen drejtuesit, bëhet prezantimi i infrastrukturës, bibliotekës, laboratorëve, etj. Studenti informohet në lidhje me këto aspekte edhe nëpërmjet materiale të detajuara që ndodhen në dosjen e tij të regjistrimit.</p> <p>Gjithashtu informacione të detajuara në lidhje me programin e studimit studentët marrin nëpërmjet komunikimit në distancë që kanë me pedagogët dhe Sekretarisë Mësimore me anë të Portalit të Studentit (“edu4school”). Informacione të tjera të vlefshme bëhen të mundura nëpërmjet faqes së web-it, zyrës së karrierës dhe Alumnit, si dhe botimeve dhe fletëpalosjeve. Një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve sidomos në periudhën e kalimit të vitit akademik 2019 – 2020 online, kanë luajtur edhe Këshilltarët Akademikë të Programeve të Studimit.</p> <p>Të gjitha burimet e sipërpërmendura të informacionit janë lehtësisht të aksesueshme nga studentët e UMT.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.87 Dosje studenti.pdf https://www.edu4schools.gr/Account/Login Aneksi Nr.43 UMT Sistemi informatik i menaxhimit të studentëve.pdf Aneksi Nr.36 Faqa Web dhe rrjetet sociale.pdf Aneksi Nr.123 Vendim i fe keshilltarët akademike dhe Axhenda e Këshilltarve Akademik.pdf</p>			
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Gjithashtu informacione të detajuara në lidhje me programin e studimit studentët marrin nëpërmjet komunikimit në distancë që kanë me pedagogët dhe Sekretarisë Mësimore me anë të Portalit të Studentit (“edu4school”). Informacione të tjera të vlefshme bëhen të mundura nëpërmjet faqes së web-it, zyrës së karrierës dhe Alumnit, si dhe botimeve dhe fletëpalosjeve. Një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve sidomos në periudhën e kalimit të vitit akademik 2019 – 2020 online, kanë luajtur edhe Këshilltarët Akademikë të Programeve të Studimit.</p> <p>Të gjitha burimet e sipërpërmendura të informacionit janë lehtësisht të aksesueshme nga studentët e UMT.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.87 Dosje studenti.pdf https://www.edu4schools.gr/Account/Login Aneksi Nr.43 UMT Sistemi informatik i menaxhimit të studentëve.pdf Aneksi Nr.36 Faqa Web dhe rrjetet sociale.pdf Aneksi Nr.123 Vendim i fe keshilltarët akademike dhe Axhenda e Këshilltarve Akademik.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë,

nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve															
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar (Rregullore e Sekretarisë) GVJ konstaton se Zyra e Sekretarisë Mësimore, është përgjegjëse për mbajtjen e statistikave vjetore për numrin e studentëve në secilin program studimi, dhe numrin e të diplomuarve përkatës. Këto statistika mblidhen dhe përpunohen në bazë të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Udhëzimit të MAS “Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore“, Udhëzimit të MAS, Nr. 16, datë 08.07.2019 “Për pajisjen e institucioneve të Arsimit të Lartë Publik dhe Privat me Regjistrat Bazë të Studentëve“, si dhe udhëzime të tjera që dalin çdo vit.</p> <p>Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore, GVJ u njoh me këto statistika që kjo zyrë mbante për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, që përmbanin: të dhëna në lidhje me mesataret në hyrje dhe në dalje, rekordet për të larguarit, transferimet, etj. Gjithashtu në këtë zyrë gjendet regjistri themeltar i studentëve, regjistri i arritjeve akademike (të notave), regjistri i lëshimit të diplomave, regjistrat e pedagogëve me vlerësimet dhe frekuentimin e studentëve, proces verbalet e notave, etj. GVJ konstatoi se të gjitha të dhënat ruhen në dokumenta fizikë (hard copy) dhe elektronike. Gjatë vizitës në institucion përfaqësues të Zyrës së Sekretarisë na vunë në dispozicion regjistrin themeltar të studentëve për këtë program studimi i plotësuar sipas standardeve që kërkon ligji.</p> <p>Përsa i përket programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, ky program është licensuar në 12.05.2010, ka filluar aktivitetin në vitin akademik 2011 – 2012 dhe është akredituar për herë të parë në 07.01.2016.</p> <p>Bazuar në dokumentin: “Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, Tabela 21” tabelat e mëposhtëme paraqesin për gjashtë vitet e fundit akademike përkatësisht:</p> <p>Tabela 1: Numri i të regjistruarve dhe mesatarja përkatëse</p> <table border="1"><thead><tr><th>Viti akademik</th><th>Student të regjistruar në vit të parë</th><th>Nota mesatare në hyrje</th></tr></thead><tbody><tr><td>2017-2018</td><td>18</td><td>7.57</td></tr><tr><td>2018-2019</td><td>13</td><td>8.1</td></tr><tr><td>2019-2020</td><td>10</td><td>8</td></tr><tr><td>2020-2021</td><td>26</td><td>8.27</td></tr></tbody></table> <p>Tabela 2: Numri i të diplomuarve dhe mesatarja përkatëse</p>	Viti akademik	Student të regjistruar në vit të parë	Nota mesatare në hyrje	2017-2018	18	7.57	2018-2019	13	8.1	2019-2020	10	8	2020-2021	26	8.27
Viti akademik		Student të regjistruar në vit të parë	Nota mesatare në hyrje													
2017-2018		18	7.57													
2018-2019	13	8.1														
2019-2020	10	8														
2020-2021	26	8.27														
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>																
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>																



Viti akademik	Numri i studentëve të diplomuar	Nota mesatare
2017-2018	16	6.29
2018-2019	30	6.33
2019-2020	20	7.15
2020-2021	14	7.33

Tabela 3: Numri i studentëve të transferuar dhe atyre të larguar

Viti akademik	Student të transferuar	Studentë të larguar
2017-2018	10	5
2018-2019	5	0
2019-2020	5	1
2020-2021	3	3

Gjithashtu në Sekretarinë Mësimore mbahet dokumentacioni që tregon rezultatet (rezultatet e ndërmjetme dhe përfundimtare) e studentëve gjatë gjithë ecurisë së programit të studimit. Rezultatet regjistrohen në procesverbalet sipas lëndëve në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 Neni 101. Më pas notat hidhen në regjistrin e notave.

Evidenca:

Aneksi Nr.95 FE Rregullore e Sekretarisë.pdf

Aneksi Nr.82 rrjeti Alumni Alumni dt.19.05.2021.pdf

Tabelat Permbledhese.pdf – Tabela 21 dhe 23

Aneksi Nr.73 Raport Vjetor FE PER MINISTRINE 2019-2020.pdf

Vendim: Mbi disa rregulla lidhur me udhëheqjen dhe mbrojtjen e tezave të diplomave“ datë 07.04.2021

Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

GVJ u informua në takimin me përfaqësues të Sekretarisë Mësimore, Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë dhe Përgjegjësën e Departamentit të Informatikës Ekonomike, që të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen në mënyrë të sigurtë në përputhje me Statutin e UMT, Neni 104, 105 dhe sipas rastit janë lehtësisht të aksesueshme për këdo që është i autorizuar (studentët, pedagogët, drejtuesit e institucionit, etj). Të dhënat ruhen në regjistra fizike dhe format elektronik. Aksesin në informacion studentët dhe pedagogët e marrin edhe nëpërmjet Portalit “edu4school” si edhe në mënyrë të dretpërdrejtë në Sekretarinë Mësimore.

Evidenca:

Aneksi Nr.01 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf

Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf

Aneksi Nr.50 FE Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf

Aneksi Nr.95 FE Rregullore e Sekretarisë.pdf

	https://www.edu4schools.gr/Account/Login Aneksi Nr.114 UMT Rregullore e arkivës.pdf			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se departamentet dhe Sekretaria Mësimore hartojnë raporte mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Shërbimit ndaj Studentit dhe Alumni analizon gjendjen e punësimit të studentëve dhe bën raportet përkatëse. Këto raporte hartohen në përputhje me kërkesat e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe në shërbim të njëjësive dhe drejtuesve të institucionit për të realizuar analizat vjetore. Këto analiza i gjejmë në dokumentat: Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike Tabela 21; Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve Tabela 23; Raport Vjetor viti akademik 2019 – 2020.</p> <p>Gjithashtu institucioni ka realizuar edhe studimin e tregut gjatë vitit 2020, për të analizuar mundësitë e punësimit të studentëve të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike dhe ka hartuar një raport duke përcaktuar edhe një plan veprimi për zhvillimin e programit në të ardhmen.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.73 Raport Vjetor FE PER MINISTRINE 2019-2020.pdf Tabelat Permbledhese.pdf – Tabela 21 dhe 23 Aneksi Nr.74 Studim tregu per programin e Studim Bach-Informatikë Ekonomike.pdf</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	<p>GVJ konstaton se përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese të UMT bëhet në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Neni 98, 99.</p> <p>Në bazë të Statutit të UMT Neni 10, 29, 103 studentët kanë të drejtë të zgjidhen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senatin Akademik – 1 anëtar i zgjedhur nga këshilli studentor - Këshillat studentorë – sipas njëjësive kryesore - Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë – 1 anëtar i zgjedhur nga këshilli studentor (presidenti i qeverisë studentore) <p>Këshilli studentor është organi më i rëndësishëm i studentëve cili përfaqëson dhe mbron interesat studentore. Ai zgjidhet çdo dy vjet në</p>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse	

<p>dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>mënyrë demokratike nga vetë studentët. UMT mbështet këshillat e studentëve dhe financon veprimtaritë e tyre nga fondi i caktuar për këto qëllime nga buxheti vjetor.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion në takimin me studentët GVJ u informua se nevojat dhe shqetësimet e tyre janë adresuar vazhdimisht në organet drejtuese dhe vendimmarrëse të institucionit (dokumenti: Kërkesa të Këshillit Studentor). Departamenti dhe Dekanati i mirëpresin sugjerimet dhe vërejtjet e studentëve për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe mardhënien me institucionin. Gjatë vitit të fundit akademik është praktikuar pjesmarrja e përfaqësuesve të studentëve çdo muaj në mbledhjet e dekanatit.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.01 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.07 VSA miratimi i perberjes se NJSBC.pdf Aneksi Nr.08 Perberja e NJSBC.pdf Aneksi Nr.106 Kërkesa të ndryshme të Këshillit Studentor të FE.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Universiteti “Metropolitan Tirana” ofron programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Informatikë Ekonomike me një kohëzgjatje 3 vjet dhe në fund të diplomimit studentët pajisen me 180 kredite evropiane (ECTS). Çdo vit akademik zgjat 30 javë mësimore i ndarë në 2 semestra me nga 15 javë. Numri i krediteve sipas viteve është përkatësisht 57 kredite për vitin e parë, 60 kredite për vitin e dytë dhe 63 kredite për vitin e tretë. Kreditet minimale europiane për një lëndë janë 3 ECTS dhe maksimumi 9 ECTS. Ka një shpërndarje të ekuilibruar ndër vite midis numrit të orëve në auditor plus studimit individual përkatësisht: 1425 orë për vitin e parë, 1500 orë për vitin e dytë dhe 1575 orë për vitin e tretë (Plani mësimor i programit: Tabelat përmbledhëse – Tabela 10). Kjo shpërndarje lehtëson edhe procedurat për transferimin e studentëve nga institucione të tjera ose drejt UMT. GVJ konstaton se gjatë hartimit dhe përmirësimit të këtij programi studimi, ngarkesa e mësipërme akademike është marrë në konsideratë, si dhe hartimi i programit është bërë në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe udhëzimet e MASR.</p> <p>Gjithashtu procedurat e vlerësimit të përparimit të studentëve apo dhe njohjet e studimeve të mëparshme bëhen në përputhje me Rregulloren e UMT, Kreu V dhe VI. GVJ konstaton që këto procedura janë të thjeshta dhe lehtësisht të kuptueshme nga studentët.</p> <p>Evidenca: Tabelat Permbledhese.pdf – Tabela 10 Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë, këshilltarëve akademikë dhe koordinatorit të programit përcillen kërkesat apo sugjerimet e studentëve në nivelet drejtuese të të gjitha niveleve.</p> <p>Një kontribut i drejtpërdrejtë në përmirësimin e procesit mësimor dhe mbarëvajtjes së programeve të studimit janë edhe raportet që nxiren nga</p>

	<p>NJSBC, pas përpunimit të pyetësorëve të studentëve ku ka jo vetëm pyetje të mbyllura por edhe pyetje të hapura ku studentët mund të lënë komente sipas këndvështrimit, apo nevojave të tyre. Këto raporte diskutohen në mbledhjet e departamenteve për të marrë masa në lidhje me shqetësimet apo sugjerimet e ngritura.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.11 Model i pyetësorit per studentet.pdf Aneksi Nr.10 Raport i sem 1 njsbc.pdf Aneksi Nr.123 Vendim i fe keshilltaret akademike dhe Axhenda e Këshilltarve Akademik.pdf Aneksi Nr.116 Minuta mbledhje departament Procesverbal Mbledhje FE.pdf</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët GVJ u informua se atyre ju jepet mundësia të vlerësojnë performancën e pedagogëve në të gjitha aspektet e procesit mësimor, që nga procesi i mësimdhënies deri tek vlerësimi. Studentët njihen me rezultatet e marra gjatë semestrit përpara provimit, dhe me rezultatin e provimit tre ditë pas zhvillimit të provimit. Ata pohuan se ju jepet e drejta të ankimojnë rezultatin e marrë të provimit, me një kërkesë me shkrim. <i>GVJ nuk gjeti evidenca të dokumentuara të procedurës së ankimit të studentit për rezultatin e provimit dhe mënyrës së zgjidhjes.</i></p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.63 FE Proçedura për zhvillimin e provimeve FE.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Në Statutin dhe Rregulloren e UMT janë përcaktuar njësitë në shërbim të studentëve si dhe procedurat që ato ndjekin. Këto njësi janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zyra e pranimet dhe këshillimit të karrierës - Zyra e shërbimit ndaj studentit dhe alumni - Përgjegjësit/koordinatorët e programeve - Sekretaria mësimore
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Këto njësi asistojnë studentin që nga regjistrimi deri në diplomim, ofrojnë informacion e këshillim për çështje të lidhura me procesin akademik dhe përfshirjen e studentëve në tregun e punës, përzgjedhjen e karrierës dhe vendin ku do të kryejnë praktikën, etj.</p> <p>Një rol të rëndësishëm në mbështetjen dhe informimin e studentëve ka departamenti i Informatikës Ekonomike dhe Këshilltari Akademik i caktuar për këtë program studimi, i cili ndihmon studentë për çdo nevojë</p>

	<p>apo problematikë që lidhet me procesin mësimor dhe i adreson ato në departament.</p> <p>Gjithashtu informimi i studentëve bëhet nëpërmjet portalit “edu4school” si, faqes së web-it dhe Guidës së studentit.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.01 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.50 FE Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf Aneksi Nr.95 FE Rregullore e Sekretarisë.pdf Aneksi Nr.123 Vendim i fe keshilltaret akademike dhe Axhenda e Këshilltarve Akademik.pdf Aneksi Nr.78 Broshura_UMT guida.pdf https://umt.edu.al/ https://www.edu4schools.gr/Account/Login</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Sikurse u cilësua edhe në kriterin 1 dhe 2 të këtij standardi, Zyra e Këshillimit të Karrierës është njësia që mirëpret studentët duke ju ofruar informacione dhe orientim të posaçëm në lidhje me karrierën, praktikat profesionale, kërkesat e tregut të punës, etj. Kjo zyrë bashkëpunon me departamentet për organizimin e praktikave profesionale, organizon paniret e punës, mban mardhënie me Alumni dhe i mbështet në organizimet e tyre, i ofron studentëve mundësi për bursa të ndryshme, mundësi për ndjekjen e shkollave verore, organizon workshop-e, trajnime, etj.</p> <p>Në bazë të dokumentit “Mbi funksionimin e zyrës së karrierës në UMT”, kjo zyrë ka si detyrë të grumbullojë informacione mbi të diplomuarit dhe të përgatisë raporte për shkallën dhe cilësinë e punësimit të tyre. Këto raporte i gjejmë në dokumentat: Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve Tabela 23; Raport Vjetor viti akademik 2019 – 2020.</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Evidenca: Aneksi Nr.77 FE Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Karrierës UMT.pdf Aneksi Nr.73 Raport Vjetor FE PER MINISTRINE 2019-2020.pdf Tabelat Permbledhese.pdf – Tabela 23 Aneksi Nr.74 Studim tregu per programin e Studim Bach-Informatikë Ekonomike.pdf Aneksi Nr.82 rrjeti Alumni Alumni dt.19.05.2021.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>




VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>UMT ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) si struktura kryesore përgjegjëse për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Kodin e Cilësisë miratuar me VKM Nr. 531, datë 11.09.2018, udhëzimet e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, si dhe aktet rregullatore institucionale. Kjo njësi funksionon në bazë të Statutit të UMT Neni 29 – 30 dhe Rregullores së NJSBC të institucionit. Kjo njësi është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>Në bazë të Statutit të UMT, NJSBC është një organ kolegjal, nën varësinë e Rektorit. Ajo përbëhet nga 6 anëtarë nga të cilët 3 janë përfaqësues të personelit akademik të njërive kryesore, 1 përfaqësues i këshillit studentor, 1 ekspert i jashtëm dhe 1 përfaqësues i administratës.</p> <p>GVJ konstaton që UMT nëpërmjet NJSBC zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe ka një sistem funksional. NJSBC monitoron cilësinë e mësimdhënies, vlerësimin periodik, ndjekjen dhe zhvillimin e pyetsorit të stafit dhe studentëve për cilësinë e ofrimit të programeve të studimit, etj.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.01 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.08 Perberja e NJSBC.pdf Aneksi Nr.09 UMT Rregullore e NJSBC.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ konstaton se UMT përdor instrumentat e duhura të Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë nëpërmjet proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit. Institucioni i është nënshtruar akreditimit institucional dhe është vlerësuar pozitivisht për pesë vite, me Vendim Nr.17 të Bordit të Akreditimit më date 15.12.2017. Gjithashtu edhe program i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike është akredituar me Urdhër Nr. 10 të MAS date 07.01.2016.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.13 Vendimi 45 i Bordit të Akreditimit Institucional.pdf Aneksi Nr.14 Vendimi Nr.104 Date 03.11.2015 Akreditimit I PROGRAMEVE TE STUDIMIT (IE) APAAL.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>NJSBC e ka përqëndruar punën për sigurimin e cilësisë në monitorimin e procesit mësimor dhe vlerësimin e mësimdhënies, vlerësimin e programeve të studimit (kurrikulave) si dhe vlerësimin e programeve të lëndëve (syllabus-eve). NJSBC është e angazhuar në anketimin e studentëve dhe pedagogëve, hartimin e raporteve të të dhënave të marra nga pyetsorët, përgatitjen e raporteve të vlerësimit të brendshëm për</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të</p>	<p>NJSBC e ka përqëndruar punën për sigurimin e cilësisë në monitorimin e procesit mësimor dhe vlerësimin e mësimdhënies, vlerësimin e programeve të studimit (kurrikulave) si dhe vlerësimin e programeve të lëndëve (syllabus-eve). NJSBC është e angazhuar në anketimin e studentëve dhe pedagogëve, hartimin e raporteve të të dhënave të marra nga pyetsorët, përgatitjen e raporteve të vlerësimit të brendshëm për</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 65

<p>Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>porcesin e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, etj. GVJ konstaton se UMT ka hartuar politika dhe procedura periodike në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, që synojnë përmirësimin e programeve të studimit që ofron (dokumenti: Politika e cilësisë në UMT).</p> <p>Në fund vitit akademik NJSBC përgatit një raport vjetor në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm të cilësisë. Raportet e NJSBC analizohen në mbledhjet e njësive bazë ku merren vendime për ndryshime apo përmirësime të mundëshme.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.121 Politika e cilesise e universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.10 Raport i sem 1 njsbc.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar GVJ konstaton se institucioni ka ngritur njësi të posaçme për monitorimin dhe rishikim e programeve të studimit. Në bazë të Nenit 8 të Rregullores së NJSBC, kjo njësi është përgjegjëse për vlerësimin e brendshëm të cilësisë në njësitë kryesore dhe programet e studimit. Ky vlerësim kryhet në mënyrë periodike. Rezultatet e këtyre vlerësimeve raportohen tek Rektori. Më pas raportet i dërgohen njësive bazë për të marrë vendime për rishikimin e syllabuseve apo kurrikulave të programeve të studimit.</p> <p>Gjithashtu procedura për rishikimin dhe modifikimin e elementëve të programit të studimit mund të fillojë nga njësia përgjegjëse për programin nëpërmjet koordinatorit të programit ose përgjegjësit të departamentit, të cilët mund të bëjnë ndryshime deri në masën 20%.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.09 UMT Rregullore e Njsbc.pdf Aneksi Nr.50 FE Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf Aneksi Nr.42 Vendim Senati Per Ndryshimin e Planit Mesimor.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ u informua në takimin me Përgjegjësin e Departamentit të Informatikës Ekonomike, përgjegjës për këtë program studimi, se në fillim të çdo viti akademik kërkohen nga personeli akademik mendime apo sugjerime në lidhje me përditësimin e syllabuseve dhe miratohen ndryshimet e mundëshme në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Gjithashtu në përfundim të çdo semestri në departament analizohen raportet e rezultateve të pyetësorëve të studentëve që realizohen nga NJSBC.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë</p>	



dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Mekanizmat kryesorë që përdor NJSBC për mbikqyrjen e programeve të studimit dhe të procesit mësimor janë: pyetsori i studentëve për zhvillimin e mësimin, pyetsori i studentit për vlerësimin e kursit, si dhe formulari i vlerësimit të performancës së stafit akademik. Përpunimi i të dhënave të pyestorëve bëhet mbi një metodologji të caktuar.			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Në raportin e hartuar nga NJSBC për vitin akademik 2020 – 2021 (Rezultatet e vlerësimit të procesit të mësimdhënies online viti akademik 2020 – 2021, semestri I) mbështetur në rezultatet e marra nga përpunimi i të dhënave të pyestorëve të studentëve, janë adresuar problematika në lidhje me procesin e mësimin online dhe janë dhënë rekomandime për përmirësimin e këtij procesi. Në raport përmbahen edhe baza ligjore mbi të cilën mbështetet anketimi i studentëve si dhe metodologjia e hartimit të raportit.			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Në bazë të rregullores së saj, NJSBC i dërgon raportet në rektorat, dhe më pas ato dërgohen në njësitë kryesore dhe njësitë bazë ku vijohet me planin e masave për të përmbushur rekomandimet e bëra.			
	Evidenca: Aneksi Nr.10 Raport i sem I njsbc.pdf Aneksi Nr.11 Model i pyetësorit per studentet.pdf Aneksi Nr.42 Vendim Senati Per Ndryshimin e Planit Mesimor.pdf Aneksi Nr.76 Minutat e një mbledhje stafi në FE.pdf Aneksi Nr.71 FE Modeli i formularit të vlerësimit të Performacës.pdf			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	GVJ konstaton se institucioni kryen në mënyrë periodike vlerësimin e brendshëm të programit të studimit nëpërmjet NJSBC. Gjatë vitit akademik NJSBC realizon vlerësime çdo semestër duke e bazuar kryesisht raportimin në analizën e pyetsorëve të studentëve për procesin mësimor. Këto raporte janë pjesë e RVB edhe për akreditimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, që po trajtohet në këtë Raport të Vlerësimit të Jashtëm. Në bazë të Rregullores së NJSBC ajo përdor instrumenta të ndryshëm për vlerësimin e cilësisë së programit dhe mbarëvajtjes së tij, instrumenta të drejtpërdrejta ose të tërthorta.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën	NJSBC realizon vlerësimin e programit dhe syllabuse në lidhje me objektivat, përputhshmërinë e tyre me përmbajtjen e lëndëve, shpërndarjen e ngarkesës së orëve gjatë vitit akademik, vlerësimin e materialeve didaktive, etj. Gjithashtu një tjetër instrument është

<p>e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>“Formulari i vlerësimit të performancës së stafit akademik” nëpërmjet të cilit vlerësohen hartimi i leksioneve të reja, përditësimi i syllabusit dhe literaturës, niveli i kërkimit shkencor, etj. Instrumenta të tjera janë edhe monitorime të drejtpërdrejta gjatë procesit të mësim, vlerësimi i kontrollit të provimeve, kontrolli i procesverbaleve, etj.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Evidenca:</p> <p>RVB-Bachelor_IE_Akreditim periodik. 07.07.2021.pdf Aneksi Nr.09 UMT Rregullore e Njsbc.pdf Aneksi Nr.10 Raport i sem 1 njsbc.pdf Aneksi Nr.11 Model i pyetësorit per studentet.pdf Aneksi Nr.11.1 Model i pyetësorit per studentet.pdf Aneksi Nr.122 Shembull plan monitorimi per mesimdhënien FE-semestri parë-2020-2021.pdf Aneksi Nr.115 Porcesverbal i kontrollit ne auditor.pdf Aneksi Nr.73 Raport Vjetor FE PER MINISTRINE 2019-2020.pdf</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Sikurse e përmendëm edhe më sipër, NJSBC përdor metoda të tërthorta për kontrollin e cilësisë së këtij programi studimi siç janë: pyetori me studentë dhe formulari i stafit akademik.</p> <p>Gjithashtu siç e kemi përmendur edhe në Standardin V.6 të këtij raporti, është detyra e Zyrës së Karrierës të grumbullojë informacione mbi të diplomuarit dhe të mbajë kontakte me ta. Kjo zyrë merret me realizimin e anketave për studentët e punësuar dhe përgatitjen e raporteve për shkallën dhe cilësinë e punësimit të tyre. Të dhënat gjenden në dokumentin “Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve Tabela 23; Raport Vjetor viti akademik 2019 – 2020”.</p> <p>Në bazë të RVB institucioni planifikon të shtojë instrumentat që përdor për të vlerësuar performancën e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, të tilla si pyetorë për stafin akademik ndihmës, personelin e TI, të cilat lidhen drejtpërdrejt me procesin e mësimdhënies. <i>GVJ sugjeron ti jepet një rëndësi e veçantë edhe anketimit të të diplomuarve të këtij programi studimi, për të vlerësuar përputhjen e kurrikulës me nevojat e tregut dhe përshtatjen e studentëve të këtij programi me njohuritë që kanë marrë në tregun e punës.</i></p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.77 FE Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Karrierës UMT.pdf Aneksi Nr.73 Raport Vjetor FE PER MINISTRINE 2019-2020.pdf Tabelat Permbledhese.pdf – Tabela 23 Aneksi Nr.74 Studim tregu per programin e Studim Bach-Informatikë Ekonomike.pdf Aneksi Nr.82 rrjeti Alumni Alumni dt.19.05.2021.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Bazuar tek dokumentacioni i shqyrtuar, Statuti i UMT, Rregullorja e UMT dhe Rregullorja e NJSBC, si dhe nga informacionet e marra gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në strukturat e ngritura për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programeve të veta të studimit. Në bazë të Statutit, si dhe për të pasur një përfshirje sa më të gjërë të të gjithë aktorëve, në strukturën e NJSBC janë përfshirë anëtarë përfaqësues të njëjve kryesore, përfaqësues të administratës, përfaqësues të studentëve si dhe një ekspert i jashtëm. Përveç anëtarëve të NJSBC që kanë detyra të përcaktuara në lidhje me zbatimin e politikave dhe procedurave që garantojnë cilësinë e brendshme, GVJ u informua se institucioni parashikon dhe përfshirjen e aktorëve të tjerë që nga stafi akademik, ai administrativ, partnerët me të cilët bashkëpunon, alumni, etj, prej të cilëve merr sugjerime për përmirësimin e cilësisë së programeve që ofron.</p> <p>Në bazë Rregullores së NJSBC, GVJ konstaton se anëtarët e kësaj njësie kanë detyra specifike të përcaktuara në nenet 8 – 14 të kësaj rregulloreje.</p> <p>Evidenca: Aneksi Nr.01 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.09 UMT Rregullore e NJSBC.pdf Aneksi Nr.08 Perberja e NJSBC.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademi e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sikurse është evidentuar edhe në kriteret e mësipërme të këtij standardi, institucioni garanton përfshirjen e drejtpërdrejtë të njësisë kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, të personelit administrativ si dhe studentëve në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë, nëpërmjet strukturës së NJSBC. Gjithashtu në porcesin e vlerësimit dhe të sigurimit të cilësisë së programit të studimit janë të përfshirë edhe pedagogët dhe studentët e tjerë, të cilët me anë të mendimeve, sugjerimeve apo nevojave të tyre, që jepen me anë të anketimeve por edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së ofrimit të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, si dhe takimeve me pedagogët dhe studentët, GVJ konstaton se anëtarët e komisioneve të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë kanë respektur integritetin akademik dhe kanë shmangur pabarazinë dhe diskriminimin. Gjatë zhvillimit të pyetsorëve është ruajtur anonimati, dhe integriteti akademik. Parimet e etikës janë të sanksionuara në Kodin e Etikës së UMT të cilat janë të detyrueshme për të gjithë aktorët.</p> <p>Evidencë: Aneksi Nr.01 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 69

	<p>Aneksi Nr.08 Perberja e NJSBC.pdf Aneksi Nr.09 UMT Rregullore e NjsBC.pdf Aneksi Nr.15 UMT Rregullore e Etikës.pdf</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Statuti i UMT dhe Rregullorja e NJSBC kanë përcaktuar që një anëtar i NJSBC të jetë ekspert i jashtëm. GVJ e konstaton këtë edhe në dokumentin (Vendim i Rektorit mbi "Miratimin e përbërjes së NJSBC) që miraton anëtarët e kësaj strukture. <i>GVJ konstaton se në Rregulloren e NJSBC nuk janë të përcaktuara qartë detyrat e anëtarit që është ekspert i jashtëm, sikurse janë përcaktuar detyrat e anëtarëve të tjerë. GVJ mendon që kontributi konkret që kanë ekspertët e jashtëm në rritjen e cilësisë së ofrimit të programit është shumë i rëndësishëm prandaj sugjeron një pjesëmarrje më evidente jo vetëm të anëtarit të NJSBC që është ekspert i jashtëm, por edhe të aktorëve të tjerë (parterët me të cilët institucioni bashkëpunon apo të diplomuarit e punësuar në tregun e punës) në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i></p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi Nr.01 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf Aneksi Nr.08 Perberja e NJSBC.pdf Aneksi Nr.09 UMT Rregullore e NjsBC.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ u informua gjatë takimit me përfaqësues të NJSBC se kjo njësi i bën transparente dhe i vë në dispozicion të të gjithë pjestarëve në institucion (personelit dhe studentëve) politikat, strategjitë dhe veprimtaritë e tjera në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Informacioni përcillet në institucion nëpërmjet njësive bazë tek stafi dhe studentët nëpërmjet shkresave zyrtare apo raporteve të hartuara nga kjo njësi. <i>Megjithatë GVJ konstaton një mungesë të këtyre informacioneve në faqen zyrtare të web-it të UMT. GVJ sugjeron publikimin e të gjithë dokumentave që lidhen me veprimtarinë e NJSBC në mënyrë që të gjithë të interesuarit të njihen me të. Përsa i përket shpërndarjes në të gjitha nivelet brenda institucionit, të rezultateve të vlerësimeve të programeve të studimit që NJSBC realizon, GVJ konstaton se publikimi i të gjitha dokumentave dhe informacioneve bëhet duke respektuar, lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</i></p> <p>Evidenca:</p> <p>https://umt.edu.al/ Aneksi Nr.73 Raport Vjetor FE PER MINISTRINE 2019-2020.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	

	RVB-Bachelor_IE_Akreditim periodik, 07.07.2021.pdf Aneksi Nr.10 Raport i sem 1 njsbc.pdf			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, GVJ konstaton që NJSBC analizon rezultatet e nxjerra nga anketimet. Në bazë të këtyre rezultateve ajo ka nxjerr edhe konkluzione dhe ka dhënë rekomandime që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive apo dobësive të evidentuara. <i>GVJ nuk konstaton ndonjë dokument që pasqyron planin e masave të marra për zbatimin e rekomandimeve të raportit të NJSBC.</i> Megjithatë gjatë takimit me Përgjegjësën e Departamentit të Informatikës Ekonomike, si dhe Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, GVJ u informua se raportet e NJSBC janë analizuar në mbledhjet e departamentit, dhe janë marrë masa për zgjidhjen e tyre. GVJ u informua se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kryesisht monitoron cilësinë nëpërmjet mekanizmave të saj, ndërsa departamentet luajnë një rol kyç në kontrollin e zbatimit të masave të marra dhe analizojnë impaktin e tyre, duke u munduar që të sigurojë efektivitetin e procesit të përgjithshëm të sigurimit të cilësisë. Evidenca: Aneksi Nr.73 Raport Vjetor FE PER MINISTRINE 2019-2020.pdf RVB-Bachelor_IE_Akreditim periodik, 07.07.2021.pdf Aneksi Nr.10 Raport i sem 1 njsbc.pdf			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ u informua gjatë takimit me Përgjegjësën e Departamentit të Informatikës Ekonomike se ata organizojnë vazhdimisht takime me personelin dhe studentët për ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Objektivi nuk është vetëm informimi por edhe pjesmarrja e tyre në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Evidenca të këtyre aktiviteteve që kanë qëllim informimin dhe ngritjen e problematikave dhe adresimin e tyre, janë mbledhjet periodike të departamentit ose dekanatit ku ka dhe pjesmarrje të përfaqësuesve të studentëve. Evidenca: Aneksi Nr.76 Minutat e një mbledhje stafi në FE.pdf Aneksi Nr.116 Minuta mbledhje departament Procesverbal Mbledhje FE.pdf Aneksi Nr.121 Politika e cilesise e universitetit Metropolitan Tirana.pdf			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	GVJ u informua gjatë takimit me Përgjegjësën e Departamentit të Informatikës Ekonomike se ata organizojnë vazhdimisht takime me personelin dhe studentët për ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Objektivi nuk është vetëm informimi por edhe pjesmarrja e tyre në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Evidenca të këtyre aktiviteteve që kanë qëllim informimin dhe ngritjen e problematikave dhe adresimin e tyre, janë mbledhjet periodike të departamentit ose dekanatit ku ka dhe pjesmarrje të përfaqësuesve të studentëve. Evidenca: Aneksi Nr.76 Minutat e një mbledhje stafi në FE.pdf Aneksi Nr.116 Minuta mbledhje departament Procesverbal Mbledhje FE.pdf Aneksi Nr.121 Politika e cilesise e universitetit Metropolitan Tirana.pdf			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Metropolitan Tirana”

Pikat e forta dhe afirmime:


1. Metodatat inovative të mësimdhënies. Institucioni i ka kushtuar një rëndësi të veçantë përdorimit të metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies duke zhvilluar vazhdimisht trajnime për stafin akademik dhe duke përdorur metoda bashkëkohore me në qendër studentin.
2. Mbështetja e studentëve. Institucioni mbështet studentët në të gjithë procesin e shkollimit, që nga hyrja deri në dalje, nën kujdesin e drejtpërdrejtë të këshilltarëve akademik dhe koordinatorit të programit të cilët janë gjithmonë pranë studentit. Gjithashtu për tu vlerësuar është pajisja e studentëve që në fillim të shkollimit me laptop personal, që është një ndikim i drejtpërdrejtë pozitiv në zhvillimin e lëndëve të këtij programi studimi.
3. Infrastruktura moderne e laboratorëve dhe mjediseve të mësimin. Institucioni ofron mjedise mësimore dhe laboratorë informatike të pajisur me infrastrukturë moderne dhe të mbuluar nga rrjeti i internetit falas.
4. Stafi akademik. Programi i studimit mbulohet nga një staf akademik i kualifikuar dhe me eksperiencë të shumta në mësimdhënie dhe në industri, si brenda edhe jashtë vendit.

Pika të dobta:

1. Mungesa e një plani të detajuar për pasurimin e bibliotekës sipas nevojave të departamenteve në mbështetje të programeve të studimit. Ka vend për përmirësimin dhe shtimin e titujve të librave në literaturën fizike apo online, sidomos në gjuhën shqipe, për të mbështetur nevojat e programit Bachelor në Informatikë Ekonomike.
2. Mungesa e informacioneve në faqen e web-it të institucionit, të nevojshme për të interesuarit në lidhje me veprimtarinë e NJSBC dhe dokumentat që prodhon kjo njësi.

Rekomandime:

1. Të hartohet një plan i detajuar për shtimin e titujve të bibliotekës, sipas kërkesave të departamentit apo programit të studimit, të përditësohet dhe shtohet literatura ekzistuese sidomos ajo në gjuhën shqipe dhe të shtohen mundësitë për të aksesuar bibliotekat online.
2. Të publikohen në faqen e web-it të institucionit informacione dhe dokumenta që lidhen me veprimtarinë e NJSBC në mënyrë që të jenë lehtësisht të aksesueshme për të interesuarit.



Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor in “Economic Informatics” of the Higher Education Institution “Metropolitan Tirana University”.

Strengths and affirmations:


1. Innovative teaching methods. The institution has paid special attention to the use of various innovative teaching methods by constantly developing training for academic staff and using contemporary teaching methods focused on the students.
2. Students support. The institution supports students throughout the education process, from the beginning until their graduation, under the direct care of the academic advisors and the program coordinator who are always close to the student. It is worth mentioning the provision of students from the beginning with a personal laptop, which has a direct positive impact on the development of the subjects of this study program.
3. Modern infrastructure of laboratories and learning facilities. The institution offers learning facilities and computer labs equipped with modern infrastructure and covered by the free internet network.
4. Academic staff. The study program is covered by a qualified academic staff with extensive experience in teaching and IT industry, both at home and abroad.

Weaknesses:

1. Lack of a detailed plan for enriching the library according to the needs of the departments in support of the study programs. There is room for improvement and increase in the number of book titles in physical literature or online, especially in Albanian language, to support the needs of the Bachelor program in Economic Informatics.
2. Lack of information on the website of the institution, necessary for those interested in the activity of the IQAU and the documents produced by this unit

Recommendations:

1. To prepare a detailed plan for increasing the number of titles in the library, according to the requirements of the departments or study programs, to update and increase the existing physical literature, especially the one in Albanian language and to increase the possibilities to access online libraries for both students and academic staff.
2. To publish on the website of the institution information and documents related to the activity of the IQAU in order to be easily accessible to those who are interested on them.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Plotë përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. CFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X